

LIGJ
Nr. 82/2024

PËR POLICINË E SHTETIT
(Ndryshuar me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton misionin, organizimin dhe funksionimin e Policisë së Shtetit në Republikën e Shqipërisë, si dhe të drejtat e detyrimeve dhe punonjësit të Policisë së Shtetit.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- përcaktimin e fushës së veprimtarisë së Policisë së Shtetit, kompetencat, organizimin dhe funksionimin e tyre;
- rregullimin e sistemit të pranimi, arsimimit dhe ecures në karrierë të punonjësve të Policisë së Shtetit, e të drejtave e të detyrimeve dhe trajtimin e veçantë të tyre;
- përcaktimin e autoriteteve e të përgjegjësive të niveleve drejtuese dhe zbatuese;
- zbatimin e parimit demokratik të kontrollit civil mbi Policinë e Shtetit;
- përcaktimin e formave të bashkëpunimit të Policisë së Shtetit me komunitetin dhe subjekte të tjera publike e private.

Neni 3
Përkufizimet

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- “Akademia e Sigurisë” është institucion i lartë arsimor i profilizuar në fushën e sigurisë publike.
- “Emërimi në detyrë” është momenti i fillimit të marrëdhënies së punës për punonjës të policisë.
- “Ecuria në karrierë” përfshin të gjitha fazat e karrierës që nga emërimi në detyrë të punonjës të policisë deri në ndërprerjen e marrëdhënies të punës.
- “Gradë policore” është shprehja e hierarkisë policore, emërtimi i çdo shkalle dhe shenja dalluese, shprehje e cilësive individuale, eksperiencës dhe rolit në përmbushjen e përgjegjësive të Policisë së Shtetit, që fitohet nga punonjësi i policisë nëpërmjet një procesi konkurrues.
- “Informacioni policor” është tërësia e të dhënave dhe fakteve që sigurohen nga policia në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, për qëllimet e përcaktuara në këtë ligj.
- “Kursant” është personi që ndjek shkollimin bazë policor me qëllim pranimin në rolin zbatues.
- “Lirimi” është ndërprerja e marrëdhënies juridike të punonjës të policisë.

8. “Ministri” është ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

9. “Masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike” janë tërësia e veprimeve të ligjshme, të cilat kryhen nga punonjësi i policisë gjatë ushtrimit të detyrës, duke respektuar dinjitetin, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe kanë si qëllim ruajtjen e rendit e të sigurisë publike nga çdo veprim ose mosveprim i kundërligjshëm. Masat fillojnë nga forma verbale e bindjes dhe mund të vazhdojnë deri në përdorimin e forcës, në mënyrë proporcionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. “Ndalimi i përkohshëm policor” është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 të këtij ligji.

11. “Përdorimi i forcës” është veprimi i drejtpërdrejtë nëpërmjet forcës fizike dhe llojeve të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit, në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi kundër torturës e trajtimit çnjerëzor, dhe kufizimeve të parashikuara në nenin 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

12. “Përjashtimi nga policia” është ndërprerja e marrëdhënieve të punës të punonjësit të policisë si pasojë e shkeljeve disiplinore, administrative apo vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

13. “Përpunimi i të dhënave personale për qëllime policore” është përpunimi i të dhënave personale nga Policia e Shtetit, me qëllim ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike dhe përfshin operacione që kryhen me të dhënat personale ose grupe të të dhënave personale, me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, deklarimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njehsimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi.

14. “Pranimi në polici” është marrja e atributëve të punonjësit të policisë me akt të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

15. “Policimi demokratik” është një model i policimit që e ka theksin te llogaridhënia, transparenca dhe zbatimi i ligjit, për një polici në shërbim të komunitetit dhe në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të personave në një shoqëri demokratike.

16. “Policimi vullnetar” është ofrimi vullnetar i shtetasve në ndihmë të Policisë së Shtetit për ruajtjen e rendit, qetësisë publike, parandalimin e krimit dhe përballimin e situatave të emergjencave civile.

17. “Punonjës policie” është personi i emëruar në strukturat e Policisë së Shtetit pas përfundimit të arsimit ose kualifikimit përkatës dhe që mban gradë policore.

18. “Reagimi i menjëhershëm” është një veprim i ligjshëm i ndërmarrë me iniciativë nga punonjësi i policisë sapo kupton rrezikun.

19. “Rend publik” është një gjendje e përgjithshme e shoqërisë, në të cilën kjo e fundit dhe anëtarët e saj kanë të garantuar integritetin e tyre fizik dhe moral nga çdo cenim apo kërcënim për cenim dhe që ligji i ndëshkon si krim apo kundërvajtje në kuadër të lirive themelore të njeriut, të njohura dhe të mbrojtura me ligj.

20. “Siguria publike” është një standard juridik, objekt i së cilës është administrimi i rreziqeve të përditshme me origjinë natyrore, njerëzore, urbane që kryhet nga aktorë publikë dhe privatë, masat normative të të cilëve janë nxjerrë nga autoritetet kombëtare e vendore në mbrojtje të integritetit të personave dhe të të mirave të tyre materiale.

21. “Struktura të veçanta” janë strukturat e policisë që veprojnë në një territor të caktuar ose në të gjithë territorin e vendit, në varësi të strukturës qendrore apo vendore.

22. “Student” është personi që ndjek programet e studimit në Akademinë e Sigurisë.

23. “Shkelje disiplinore” është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit të policisë, që nuk përbën vepër penale, që bie në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë apo janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

24. “Të dhëna personale dhe transferimi ndërkombëtar i tyre” ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen e të dhënave personale.

25. “Transferim” është kalimi në një detyrë tjetër i punonjësit të policisë me të njëjtën gradë.
26. “Varësi lëndore” është varësia që kanë strukturat vendore në raport me strukturën qendrore.
27. “Veprimtaria hetimore” është veprimtaria që kryhet në përputhje me atributet e Policisë Gjyqësore, sipas Kodit të Procedurës Penale.

Neni 4

Misioni i Policisë së Shtetit

Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, parandalimin dhe luftën ndaj kriminalitetit, garantimin e zbatimit të ligjit, mbrojtjen e jetës e të pronës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Kompetenca territoriale

Policia e Shtetit ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Policia e Shtetit mund të ushtrojë veprimtarinë edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura për këtë qëllim.

Neni 6

Statusi i Policisë së Shtetit

Policia e Shtetit është institucion i administratës shtetërore, e depolitizuar, person juridik në varësi administrative të ministrit, statusi i së cilës nuk ndryshon edhe në gjendje lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo të fatkeqësisë natyrore.

Neni 7

Parimet e veprimtarisë

1. Në ushtrimin e përgjegjësisë së saj, Policia e Shtetit ndjek modelin e policimit demokratik dhe udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- a) ligjshmëria;
- b) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- c) barazia dhe mosdiskriminimi;
- ç) profesionalizmi, integriteti dhe përgjegjësia në shërbimin publik;
- d) hierarkia dhe llogaridhënia në ushtrimin e funksioneve;
- dh) transparenca dhe besueshmëria;
- e) paanshmëria;
- ë) përgjegjshmëria;
- f) ushtrimi i ligjshëm i diskrecionit;
- g) legjitimiteti, përshtatshmëria dhe proporcionaliteti.

2. Në trajtimin e punonjësve të saj Policia e Shtetit udhëhiqet nga parimi i integritetit, objektivitetit, meritës, transparencës, garantimit të zhvillimit të karrierës profesionale dhe mosdiskriminimit.

Neni 8

Fushat e veprimtarisë së Policisë së Shtetit

Policia e Shtetit e realizon misionin e saj përmes fushave të veprimtarisë policore:

- a) lufta kundër kriminalitetit në tërësi, krimin të organizuar dhe krimeve të rënda në veçanti në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) mbikëqyrja e kufirit shtetëror, kontrolli i hyrjeve-daljeve në kufi, si dhe trajtimi i shtetasve të huaj ose personave pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) ruajtja e rendit, sigurisë publike, sigurisë rrugore nëpërmjet policimit në komunitet në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9

Përgjegjësitë e Policisë së Shtetit

1. Policia e Shtetit ushtron përgjegjësitë dhe funksionet e mëposhtme:

a) mbron jetën dhe shëndetin e personave;

b) garanton paprekshmërinë e pronës publike dhe private;

c) ruan rendin dhe sigurinë publike;

ç) mbledh të dhëna dhe fakte, parandalon, heton dhe zbulon, në përputhje me legjislacionin në fuqi, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre;

d) grumbullon dhe administron informacion policor, përfshirë atë të klasifikuar, vetëm për përmbushjen e misionit të saj;

dh) kryen detyra në përmbushje të atributit të Policisë Gjyqësore, sa herë i kërkohet nga organet proceduese, sipas parashikimeve në legjislacionin penal e procedural penal;

e) organizon fushata ndërgjegjësuere dhe informuese, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale, si dhe rritjen e bashkëpunimit me publikun;

ë) merr drejtimin dhe përgjegjësinë e menaxhimit të incidenteve që cenojnë rendin dhe sigurinë publike me mbërritjen në vendin e ndodhjes së tyre, me mbështetjen e shërbimeve të tjera publike ose private që ushtrojnë veprimtarinë, ndodhen apo vijnë në vendin e incidentit;

f) shoqëron në ambientet e saj personat e arrestuar ose të ndaluar deri në caktimin e masës së sigurimit me vendim gjykatë, si dhe të dënuarit me vendim të formës së prerë në mungesë, deri në transferimin e tyre në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në përputhje me procedurat dhe afatet e legjislacionit procedural penal në fuqi dhe në respektim të të drejtave kushtetuese;

g) organizon kapjen e personave në kërkim për kryerjen e veprave penale ose gjetjen e personave të humbur dhe i dorëzon ata tek autoritetet kompetente;

gj) mbikëqyr dhe drejton trafikun rrugor në rrugët për përdorim publik në përputhje me legjislacionin rrugor;

h) mbikëqyr dhe kontrollon kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë;

i) kontrollon regjimin e hyrje-daljeve të të huajve ose personave pa shtetësi, të qëndrimit, të punësimit e të trajtimit të tyre në Republikën e Shqipërisë;

j) identifikon, mbron dhe referon për asistencë pranë autoriteteve përkatëse viktimat e trafikimit, të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, veçanërisht të miturit, gratë dhe personat nga grupe vulnerabël;

k) administron dhe mbron informacionin e klasifikuar, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në legjislacionin në fuqi;

l) merr, trajton, si dhe referon pranë strukturave përgjegjëse ankesat e shtetasve, në mënyrë të veçantë, kallëzimet penale, si dhe informacionet e dhëna në rrugë të ndryshme për vepra penale;

ll) garanton ruajtjen e rendit e të sigurisë publike gjatë proceseve zgjedhore ose referendumeve;

m) kryen detyra të tjera të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

2. Në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, pandemive, të fatkeqësive natyrore apo aksidenteve teknologjike, u siguron ndihmë autoriteteve shtetërore qendrore e vendore, shërbimeve të emergjencës, kërkim-shpëtimit, shërbimit zjarrfikës, si dhe personave juridikë e fizikë.

3. Çdo punonjës i policisë, gjatë kryerjes së detyrës ose jashtë saj, vepron në përmbushje të nevojave dhe pritshmërive të publikut për garantimin e rendit e të sigurisë publike, si dhe e përdor autoritetin që i jep ligji vetëm për këtë qëllim.

KOMPETENCAT E POLICISË DHE MASAT PËR RUAJTJEN E RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE

Neni 10

Veprimet e punonjësit të policisë për zbatimin e masave për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike

1. Punonjësi i policisë vepron për të parandaluar një veprim ose mosveprim të kundërligjshëm ose ndërhyrjen menjëherë për të ndërprerë pasojat e paligjshme që mund të vijnë dhe që përbëjnë rrezik të drejtpërdrejtë për jetën e njeriut, shëndetin, sigurinë e tij ose pronën.
2. Punonjësi i policisë, para se të fillojë zbatimin e një mase për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike ndaj një shtetasi, është i detyruar të identifikohet.
3. Kur cenimi i rendit dhe sigurisë publike ka ardhur si pasojë e veprimeve të të miturit, punonjësi i policisë merr masa për të ndërprerë veprimet e paligjshme dhe njofton prindin ose kujdestarin e tij. Trajtimi i mëtejshëm i të miturit kryhet nga punonjësi policie të trajnuar për këtë qëllim.
4. Në rastet kur i mituri nuk ka prind apo kujdestar apo këta nuk identifikohen brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj, Policia e Shtetit njofton njësinë përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.
5. Procedura e identifikimit para fillimit të zbatimit të masave, llojet, rendi i përshkallëzimit, mënyrat e dokumentimit dhe të vlerësimit të masave të nevojshme miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 11

Masat e menjëhershme dhe proporcionaliteti në zbatimin e tyre

1. Veprimi dhe ndërhyrja për të shmangur apo ulur rrezikun, përfundimisht apo përkohësisht, duhet të synojë neutralizimin e tij dhe të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë, të drejtat dhe interesat që vihen në rrezik ose cenohen.
2. Kur veprimi apo ndërhyrja janë të paefektshme, atëherë mund të zgjidhet një masë tjetër proporcionale, e përshkallëzuar, për uljen e rrezikut.
3. Zbatimi i çdo mase të ndërmarrë ndërpritet menjëherë kur rreziku është shmangur apo shkakun që e diktoi nuk ekziston më.

Neni 12

Paralajmërimi për marrjen e masave

1. Punonjësi i policisë njofton personin për çdo rrethanë, veprim ose mosveprim që kërcënon ose mund të kërcënojë rendin dhe sigurinë publike.
2. Në rastin e personit juridik, njoftimi i bëhet përfaqësuesit ligjor ose personit të autorizuar ose ngarkuar prej tij për marrëdhëniet me të tretët.
3. Njoftimi duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i drejtpërdrejtë. Ai mund të jepet në mënyrë verbale, të shkruar ose nëpërmjet mjeteve të komunikimit publik, sipas rastit.

Neni 13

Detyrimi për marrjen e masave

1. Punonjësi i policisë urdhëron personin për të kryer ose për të mos kryer veprime të caktuara apo të mëtejshme, në një rrethanë të caktuar, me qëllim zbatimin e detyrave të Policisë së Shtetit, sipas parashikimeve të këtij ligji.
2. Në rastin e personit juridik, urdhri i njoftohet përfaqësuesit ligjor ose personit të autorizuar ose të ngarkuar prej tij për marrëdhëniet me të tretët.
3. Urdhri duhet të jetë i ligjshëm, i kuptueshëm dhe i drejtpërdrejtë. Ai mund të jetë verbal, i shkruar ose nëpërmjet mjeteve të komunikimit publik.

Neni 14

Veprime në rast rrezikshmërie nga sendet

Punonjësi i policisë, kur konstaton ose informohet se rendi dhe siguria publike rrezikohen apo cenohen nga gjendja e përgjithshme fizike e një sendi ose vendndodhja e tij, njofton dhe merr masa ndaj pronarit të sendit për të ndaluar gjendjen e rrezikshmërisë ose përkeqësimin e saj. Masa merret edhe ndaj personit që e disponon apo e përdor sendin.

Neni 15

Masat ndaj personave të tretë dhe e drejta e kompensimit

1. Masa për kufizimin e një të drejte mund të merren edhe ndaj personave të tretë ndaj të cilëve nuk zbatohen parashikimet e neneve 11 deri në 14 të këtij ligji, në qoftë se cenimi apo rreziku real dhe i çastit për rendin dhe sigurinë publike nuk mund të shmangen ndryshe.

2. Në çdo rast të bashkëpunimit vullnetar ose të përdorimit me forcë të sendeve të personave të tretë, punonjësi i policisë dokumenton në praninë e tyre të gjitha veprimet nëpërmjet procesverbalit përkatës.

3. Në rast dëmtimi apo humbjeje të vlerës së sendeve gjatë bashkëpunimit vullnetar ose përdorimit me forcë të tyre, personi i tretë ka të drejtën të kompensohet për shpërblimin e dëmeve ose nga zhvleftësimi i pasurisë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore dhe Kodit Civil.

Neni 16

Shpërblimi i personit për ndihmën e dhënë

1. Çdo person mund të ndihmojë policinë për kryerjen e detyrave të përcaktuara në ligj.

2. Nëse gjatë ose për shkak të ndihmës që i jep policisë, personi plagoset, sëmurët apo humbet aftësitë e tij për punë, ai ka të drejtë të përfitojë çdo ndihmë mjekësore, pension, pagesë për paaftësi në punë dhe pagesë në rast vdekjeje që përfiton edhe një punonjës i policisë sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Paga mbi të cilën llogariten përfitimet e mësipërme, është ajo që përfitonte personi në vendin e tij të punës ose paga për të cilën është siguruar në mënyrë vullnetare deri në 30 ditë para ndodhjes së ngjarjes. Në rastet kur personi nuk është në marrëdhënie pune ose i siguruar, paga mbi të cilën llogariten këto përfitime është paga bazë për gradën “Inspektor”.

Neni 17

Masa administrative

Kur punonjësi i policisë konstaton një kundërvajtje administrative për të cilën është përgjegjës sipas ligjit të posaçëm, merr masa administrative sipas legjislacionit të posaçëm. Kur ligji i posaçëm parashikon një tjetër organ administrativ përgjegjës, atëherë ai ia përcjell, pa vonesë, rastin organit administrativ që ka të drejtën e shqyrtimit të kundërvajtjes dhe të nxjerrjes së vendimit përkatës për kundërvajtjen administrative, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 18

Kontrolli dhe verifikimi i identitetit

1. Punonjësi i policisë bën kontrollin e identitetit të personit kur:

a) për rrethana të kohës dhe vendit, dyshohet se është përfshirë në veprime të kundërligjshme;

b) gjendet në një zonë, vend, ambient, ndërtesë ose në territorin në afërsi të tyre, ku lëvizja e lirë është e ndaluar ose e kufizuar;

c) gjendet në një zonë, vend, ambient ose ndërtesë, ku ndërmerren masa për kërkimin e autorit të dyshuar të veprës penale, kundërvajtjes ose objekteve dhe gjurmëve të rëndësishme për procedimin penal ose kundërvajtjen;

ç) konstatohet se po kryen shkelje administrative për të cilat ligji ngarkon me përgjegjësi Policinë e Shtetit.

2. Për një identifikim të besueshëm të personit, punonjësi i policisë bazohet në dokumentet ligjore të identifikimit apo dokumente të tjera personale, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në raste të veçanta, kur verifikimi i identitetit të personit nuk është i mundur përmes dokumentacionit ose mjeteve të tjera të identifikimit të tij, struktura përkatëse policore autorizohet të bëjë publike pamje, regjistrim ose përshkrim të personit, për të mundësuar identifikimin e tij nga persona të tretë.

4. Procedurat për kontrollin e identitetit të personit nga punonjësi i policisë përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

Neni 19

Ndalimi i përkohshëm policor

1. Ndalimi i përkohshëm policor zbatohet:

a) kur personi refuzon të identifikohet ose të japë gjeneralitetet në rastet e pikës 1 të nenit 18, apo paraqet dokumente identifikimi që dyshohet se janë të rreme;

b) për të parandaluar kryerjen e veprimeve të rrezikshme nga personi në dëm të jetës dhe shëndetit të tij ose personave të tretë ose pronës;

c) për ta mbrojtur personin nga rreziku dhe dëmi, veçanërisht kur personi s'ka mundësi për t'u mbrojtur;

ç) për zbatimin e masave kufizuese administrative, që ndalojnë hyrjen në objekte ose mjedise të caktuara sipas legjislacionit përkatës.

2. Në rastin e ndalimit të përkohshëm policor nuk zbatohen të njëjtat masa me ato për personin e ndaluar ose të arrestuar. Ndalimi i përkohshëm policor fillon që në momentin kur punonjësi ndalon personin dhe zgjat deri në sqarimin e çështjes, por në asnjë rast më shumë se 5 orë.

3. Dispozitat për ndalimin e përkohshëm policor nuk zbatohen ndaj personit, lëvizshmëria e të cilit është e pamundur për shkak të gjendjes shëndetësore, shtatzënisë ose aftësisë së kufizuar, nëse zbatimi i kësaj mase do të përkeqësonte situatën shëndetësore të personit. Në rastet e mësipërme, punonjësi i policisë ka detyrimin të mbajë procesverbal, ku dokumentohen rrethanat e moszbatimit të masës së ndalimit të përkohshëm policor.

4. Personi ndaj të cilit zbatohet ndalimi i përkohshëm policor, ka të drejtë të informohet menjëherë në gjuhën që kupton për shkaqet e këtij ndalimi, se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar ose avokatin e tij mbrojtës.

5. Punonjësi i policisë regjistron ose njofton menjëherë për gjeneralitetet e personit, kur ato njihen, orën e saktë dhe shkaqet e ndalimit të përkohshëm policor. Mosrespektimi nga punonjësi i policisë i detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.

6. Punonjësi i policisë dokumenton veprimet e kryera me personin e ndaluar përkohësisht, sipas procedurave standarde të miratuara me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Një kopje e dokumentacionit i vihet në dispozicion personit të ndaluar përkohësisht.

7. Të dhënat dhe veprimet e kryera me personat në ndalim të përkohshëm policor dokumentohen gjithashtu në sistemet, regjistrat ose librat që mbahen për këtë qëllim.

8. Rregullat e ndalimit të përkohshëm policor, evidentimit, mbajtjes dhe trajtimit të personave të ndaluar në ambientet e posaçme të Policisë së Shtetit përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

Neni 20

Njoftimi për paraqitje në ambientet e Policisë së Shtetit

1. Punonjësi i policisë njofton personin me shkrim apo mjete të komunikimit elektronik për t'u paraqitur në ambientet e policisë:

- a) për të marrë informacion për parandalimin e veprimit ose mosveprimit të kundërligjshëm;
- b) për të identifikuar personin që mund të ketë dijeni për rrezikun apo incidentin;
- c) për të identifikuar shkelësin e mundshëm të ligjit.

2. Ky njoftim duhet të pasqyrohet në një procesverbal të posaçëm, në të cilin duhet të tregohen të dhënat e kontaktit dhe mjetet e komunikimeve elektronike të përdorura për njoftim, data dhe ora e saktë e komunikimit, personi me të cilin komunikon dhe qëllimi i njoftimit.

3. Njoftimi përmban arsyen e paraqitjes, të dhëna për punonjësin e policisë, kohën, vendin dhe informacionin për të kontaktuar punonjësin e policisë, në rast pamundësie për t'u paraqitur.

Neni 21

Shoqërimi, arrestimi dhe ndalimi

Punonjësi i policisë bën shoqërimin, arrestimin dhe ndalimin e personit, duke i garantuar atij të drejtat sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 22

Kontrolli i personit

1. Punonjësi i policisë kontrollon çdo person të arrestuar ose të ndaluar, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionin në fuqi.

2. Pavarësisht parashikimit në pikën 1, punonjësi i policisë ka të drejtë të kontrollojë çdo person në rastet kur kjo është e domosdoshme:

- a) për të shmangur një rrezik real dhe të çastit;
- b) për heqjen e objekteve ose sendeve që mund të rrezikojnë jetën e tij ose të të tjerëve;
- c) për të siguruar prova për kryerjen e veprës penale sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

3. Kontrolli kryhet gjithmonë duke respektuar dinjitetin dhe integritetin fizik e moral të personit në një nga format si më poshtë:

a) kontrolli në publik i rrobave të trupit të një personi, i cili kufizohet në një kontroll sipërfaqësor të veshjeve të jashtme;

b) kontrolli i imët, i cili kryhet në vende të caktuara që nuk shihen nga publiku, ku personi i ndaluar ose i arrestuar nuk shihet nga persona të tjerë, përfshin heqjen e më shumë se veshjeve të jashtme. Kontrolli i imët mund të kryhet vetëm nëse ai vlerësohet i nevojshëm për të gjetur sendin e ndaluar dhe punonjësi i policisë gjykon që personi i arrestuar apo i ndaluar mund ta ketë fshehur atë.

4. Në çdo rast të ushtrimit të kontrollit, punonjësi i policisë dokumenton në procesverbal arsyen e ushtrimit të kontrollit, veprimet e kryera dhe sendet e gjetura, sipas procedurave standarde të miratuara me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Një kopje e dokumentacionit i vihet në dispozicion personit të kontrolluar.

5. Procedurat dhe mënyrat e kontrollit të personit nga punonjësi i Policisë së Shtetit përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

Neni 23

Veprimet për kontrollin mjekësor të personit nga punonjësi i policisë

1. Me vendim gjykatë, për të parandaluar kërcënimin për jetën, personit mund t'i bëhet kontroll mjekësor, t'i merren kampione të gjakut ose të kryhen ndërhyrje të tjera në trup nga një mjek. Kontrolli mjekësor i personit kryhet në përputhje me rregullat mjekësore për qëllime ekzaminimi,

lejohej pa miratimin e personit, nëse kjo nuk dëmton shëndetin e tij dhe masa vlerësohet e nevojshme nga mjeku.

2. Në raste të kërcënimit të menjëhershëm, punonjësi i policisë, me nismën e tij, e dërgon personin në institucionin përkatës mjekësor.

3. Të dhënat e mbledhura gjatë kontrollit përdoren vetëm për qëllimin e këtij neni.

Neni 24

Trajtimi i ankesave ndaj veprimeve policore

1. Punonjësi i policisë regjistron, verifikon, ndjek, trajton dhe kthen përgjigje për çdo ankesë të personave, sipas procedurave dhe afateve ligjore.

2. Rregullat e hollësishme dhe mënyra e dokumentimit të trajtimit të ankesave përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

Neni 25

Masat mbrojtëse ndaj personit

1. Masat mbrojtëse merren ndaj personit me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor sipas legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor, ndaj personit në gjendje të dehur, nën efektet e lëndëve narkotike ose ndaj personit që është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse dhe i rrezikshëm për shoqërinë. Në këto raste, punonjësi i policisë e dërgon personin në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit ose e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës ose, sipas rastit, njofton strukturat përkatëse të specializuara për marrjen e masave mbrojtëse ndaj gjendjes së personit.

2. Punonjësi i policisë merr masat e nevojshme për mbrojtjen e personit, gjendja e të cilit tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tij dhe për këtë arsye mund t'i shkaktojë dëmtime fizike ose të përbjë rrezik për jetën e tij ose të tjerëve.

3. Mbajtja e personit në ambientet e policisë vazhdon për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më shumë se 5 orë.

4. Për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, punonjësi i policisë mund të bëjë kontrollin dhe këqyrjen fizike të këtyre personave në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

5. Veprimet e mësipërme për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në këtë dispozitë dokumentohen. Një kopje e dokumentacionit i vihet në dispozicion personit ndaj të cilit janë marrë masat mbrojtëse, ose familjarit apo kujdestarit të tij.

Neni 26

Masat mbrojtëse ndaj të miturve

1. Punonjësi i policisë merr masat e nevojshme për mbrojtjen e të miturit të braktisur ose që është larguar nga prindi ose kujdestari i tij.

2. Punonjësi i policisë e referon rastin në njësinë përkatëse për mbrojtjen e fëmijës për një vlerësim të rastit të të miturit. Në çdo fazë të zbatimit të masave sipas këtij kreu dhe trajtimit të të miturve kërkohet prania e psikologut dhe punonjësit social.

3. I mituri dërgohet në qendrat e përkujdesjes shoqërore për të miturit kur vlerësohet se është i keqtrajtuar apo i braktisur nga prindi ose kujdestari i tij. Menaxhimi i rastit të të miturit bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aktet nënligjore për referimin, masat e mbrojtjes, menaxhimin sipas planit individual të mbrojtjes dhe financimit të tij.

4. I mituri mbahet në ambientet e policisë për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më shumë se 5 orë. Kushtet e mbajtjes së të miturit në ambientet e policisë duhet të jenë në përputhje me nevojat e moshës, nivelin e zhvillimit fiziko-psikologjik dhe gjendjen psikologjike të tij. Intervista zhvillohet në mjedise miqësore të përshtatshme dhe të aksesueshme për të miturit.

5. Rregullat për kryerjen e veprimeve të parashikuara në këtë nen përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

Neni 27

Kontrolli i objekteve, mjediseve dhe mjeteve

1. Punonjësi i policisë kontrollon objektet, mjediset dhe mjetet në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionin në fuqi.
2. Punonjësit të policisë i lind e drejta të kontrollojë objektet, mjediset ose mjetet kur:
 - a) është e nevojshme të parandalohet një kërcënim i çastit për jetën, shëndetin ose pronën;
 - b) do të zhvillohen aktivitete publike për të cilat Policia e Shtetit ka ose merr detyrimin për të garantuar rendin dhe sigurinë publike;
 - c) ka një dyshim të arsyeshëm bazuar në rrethana faktike të mjaftueshme për të ngritur supozimin se në një mjedis apo mjet të caktuar do të gjenden sende apo prova që lidhen me kryerjen e një vepre penale. Në këtë rast, punonjësi i policisë ka detyrimin ta dokumentojë shkakun e kontrollit.
3. Punonjësi i policisë dokumenton veprimet e kryera gjatë kontrolleve sipas procedurave standarde të miratuara me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 28

Kontrolli në rastet kur dyshohet për akte terroriste

1. Punonjësi i policisë, kur ka dyshime të arsyeshme, ka të drejtë të kryejë me iniciativë kontrolle për parandalimin e akteve terroriste në ndërtesa, mjedise dhe hapësira publike për të garantuar sigurinë e personave dhe të rendit kushtetues e sigurinë ndërkombëtare.
2. Punonjësi i policisë, kur ka dyshime të arsyeshme, ka të drejtë të kryejë me iniciativë kontrolle për parandalimin e akteve terroriste në banesa, pas marrjes së autorizimit me shkrim apo me mjete të komunikimit elektronik nga prokurori.
3. Kontrolli kundër akteve terroriste përfshin kontrollin për lëndë helmuese kimike, biologjike, bakteriologjike, bërthamore apo radioaktive apo të çdo natyre tjetër, të dëmshme dhe të rrezikshme për jetën dhe pronën.
4. Kontrolli ushtrohet në rastet e flagrancës, në rast ndjekjeje të personit, si dhe kur ka prova apo informacione të besueshme se është duke u përgatitur një akt terrorist dhe kur nga vonesa e ushtrimit të kontrollit mund të zhduken ose të humbasin mjetet ose gjurmët e kryerjes së krimit.
5. Pas ushtrimit të kontrollit, punonjësi i policisë harton procesverbalin përkatës dhe ia dërgon brenda 48 orëve prokurorit të vendit ku është bërë kontrolli. Një kopje e procesverbalit i lihet pronarit ose poseduesit të objektit apo personit të kontrolluar.
6. Personi i kontrolluar nga policia ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën kompetente ku ndodhet struktura policore, nëse e konsideron kontrollin si të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin.

Neni 29

Largimi nga vendndodhja dhe evakuimi

Për të shmangur kërcënimin për rendin ose sigurinë në mjedise publike, punonjësi i policisë mund të urdhërojë personin të largohet nga vendndodhja, mund ta ndalojë atë të hyjë në mjedise ose të evakuojë personat e pranishëm, për aq kohë sa ky kërcënim vazhdon. Pas ushtrimit të kontrollit, punonjësi i policisë harton procesverbalin përkatës ku dokumenton veprimet e kryera.

Neni 30

Bllokimi i rrugëve

1. Për nevoja të rendit e të sigurisë publike dhe të zbatimit të ligjit ose në rastet e fatkeqësive natyrore apo të aksidenteve, punonjësi i policisë bllokoi pjesë të rrugëve ose të mjediseve publike deri në kryerjen e veprimeve të nevojshme ligjore.

2. Rastet e bllokimit dhe procedurat që ndiqen për bllokimin e rrugëve përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

Neni 31

Bllokimi i sendeve

1. Sendet bllokohen ose sekuestrohen vetëm në rastet kur lejohet me ligj dhe në përputhje me procedurat përkatëse ligjore.

2. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj, sendet mund të bllokohen vetëm nëse është krejtësisht i pashmangshëm evitimi i kërcënimit të çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike.

3. Punonjësi i policisë, që vepron, harton procesverbalin përkatës, i cili i jepet poseduesit, nëse ai njihet.

4. Sendet bllokohen për një periudhë sa është e nevojshme, por jo më shumë se afati maksimal i parashikuar nga legjislacioni i posaçëm që lejon bllokimin ose sekuestrimin e sendit. Kur legjislacioni i posaçëm nuk ka afat ose kur bllokimi kryhet sipas pikës 2 të këtij neni, sendet nuk mund të bllokohen më shumë se 30 ditë. Pas kësaj, sendet i kthehen poseduesit nëse është identifikuar ose nëse identifikohet, pa vonesë. Nëse brenda 100 ditëve nga bllokimi, siç mund ta kërkojë natyra e sendit, poseduesi i sendit nuk mund të identifikohet ose nuk kërkon me dëshirën e tij kthimin e sendit, sendi i bllokuar kalon në favor të shtetit, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon një rregullim të ndryshëm.

5. Policia ka përgjegjësinë të kryejë verifikime për identifikimin e pronarit të sendeve të bllokuara.

Neni 32

Rastet dhe format e përdorimit të forcës

1. Punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e domosdoshme dhe nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura.

2. Punonjësi i policisë përdor forcën në mënyrë proporcionale dhe të përshkallëzuar, duke përzgjedhur nivelin e nevojshëm të forcës.

3. Punonjësi i policisë duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj, si dhe të paralajmërojë përshkallëzimin e saj, me përjashtim të rasteve kur përdorimi i menjëhershëm i forcës është i nevojshëm për të parandaluar një rrezik real dhe të çastit.

4. Përdorimi i forcës bëhet gjithnjë në përputhje me legjislacionin në fuqi kundër torturës dhe trajtimeve apo dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese dhe sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e Policisë së Shtetit.

Neni 33

Përdorimi i armëve të zjarrit

Punonjësi i policisë përdor armën e zjarrit vetëm në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.

Neni 34

Kryerja e operacioneve speciale

1. Operacionet speciale kryhen nga strukturat e posaçme të policisë dhe përfshijnë rastet si më poshtë:

a) çlirimin e pengjeve;

b) kapjen e personave të armatosur me rrezikshmëri të lartë dhe transportimin e tyre në mjediset e policisë;

c) mbështetjen e strukturave, të cilat sigurojnë personalitetet e larta shtetërore, të vendit ose të huaja, në rastet kur ka të dhëna për akte terroriste ndaj tyre;

ç) rivendosjen e rendit dhe të sigurisë publike, kur kjo është e pamundur me strukturat e tjera policore, ligjzbatuese dhe të sigurisë;

d) marrjen në ruajtje të personave, të cilëve u kërcënohet jeta për shkak të detyrës.

2. Punonjësve të strukturave të posaçme u garantohet fshehtësia e identitetit për veprimtarinë operacionale.

3. Procedurat, rregullat dhe kriteret e përdorimit të strukturave të posaçme miratohen nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

KREU III MBLEDHJA DHE ADMINISTRIMI I INFORMACIONIT POLICOR

Neni 35

Burimet e informacionit

Në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj policia mbledh informacion policor nga burimet si më poshtë:

a) gjatë procesit të shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave;

b) të dhëna dhe fakte që sigurohen nga policia në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, me qëllim ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, si dhe për parandalimin e veprave penale;

c) të dhëna që sigurohen nga të dhënat kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilat Policia e Shtetit ka akses të drejtpërdrejtë ose me marrëveshje me autoritetin përkatës;

ç) të dhëna që mblidhen për ushtrimin e përgjegjësiave të përcaktuara në ligje të veçanta.

Neni 36

Të dhënat e mbledhura gjatë procesit të ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit, dhe arrestimit të personit

1. Gjatë procesit të ndalimit të përkohshëm policor sipas këtij ligji ose ndalim dhe arrestimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, punonjësi i Policisë, për qëllim identifikimi, mbledh këto të dhëna:

a) në rast të ndalimit të përkohshëm policor, regjistron për çdo person të ndaluar përkohësisht, për qëllim identifikimi, të dhënat për:

i. gjeneralitetet;

ii. vendbanimin;

iii. përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;

iv. punën që kryen;

v. arsyet e shoqërimit;

vi. orën, datën dhe vendin e ndalimit të përkohshëm policor;

vii. zyrën e policisë ku është kryer ndalimi i përkohshëm policor;

viii. punonjësin e policisë, i cili ka kryer ndalimin e përkohshëm policor.

b) në rast arrestimi apo ndalimi, regjistron për çdo person të dhënat për:

i. gjeneralitetet;

ii. vendbanimin;

iii. përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;

iv. punën që kryen;

v. veprën penale për të cilën është arrestuar apo ndaluar;

vi. hollësi për mënyrën e kryerjes së veprës penale për të cilën është arrestuar apo ndaluar, të cilat merren në prani të mbrojtësit në rast se personi nuk e refuzon atë;

- vii. orën, datën dhe vendin e arrestimit apo të ndalimit;
- viii. zyrën e policisë ku është mbajtur;
- ix. punonjësin e policisë, i cili ka kryer arrestimin apo ndalimin.

c) nga çdo person i arrestuar apo i ndaluar, për ato vepra penale për të cilat është e nevojshme, merr të dhënat e mëposhtme:

- i. për shenjat e gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve të duarve;
- ii. dy fotografi, një pamje ballore dhe një profil;
- iii. mostra të zërit të të arrestuarit apo të të ndaluarit.

ç) përveç të dhënave të përcaktuara më sipër, në rastet e arrestimit ose ndalimit, punonjësi i policisë mund të marrë kampionë biologjikë, me qëllim përcaktimin e profilit të ADN-së, pasi prokurori të ketë marrë pëlqimin e personit, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

2. Të dhënat e përcaktuara në këtë nen mbledhen dhe administrohen duke respektuar kushtet për mosndërhyrje të paligjshme në jetën private. Këto të dhëna regjistrohen në bankën qendrore për regjistrimin e të dhënave.

3. Mënyra e organizimit dhe administrimit të të dhënave të mbledhura në rastet e ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit ose arrestimit të personave, afati i ruajtjes, kontrolli dhe fshirja e tyre përcaktohet me urdhër të përbashkët të ministrit dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 37

Të dhënat e mbledhura në kuadër të veprimtarisë informative parandaluese

1. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga policia kufizohet vetëm për fakte të nevojshme që synojnë:

- a) parandalimin dhe shmangien e një rreziku ndaj rendit e sigurisë publike;
- b) parandalimin e veprave penale, përfshirë mbajtjen nën monitorim të personave me precedent kriminal, si edhe atyre personave nën mbrojtje të veçantë;
- c) zbulimin e veprave penale dhe identifikimin e autorëve të veprave penale;
- ç) lokalizimin, gjetjen dhe kapjen e personave që i largohen drejtësisë apo janë të dënuar me një vendim gjyqësor.

2. Punonjësi i policisë nuk ka kufizime për të kërkuar, gjetur dhe komunikuar me burime të informacionit, me kushtin që informacioni të jepet me vullnet të lirë nga burimi dhe ky i fundit të ketë zotësi për të vepruar.

3. Punonjësi i policisë mbledh të dhëna nga burime të hapura publike, përfshirë ato mediatike, regjistrimet e kamerave në mjedise publike, si dhe baza të dhënash të krijuara nga agjenci shtetërore në të cilat i është garantuar akses i ligj ose me marrëveshje për njohjen dhe përdorimin e të dhënave.

4. Mbledhja dhe përdorimi i këtyre të dhënave duhet të bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Policia mbledh dhe trajton të dhëna që burojnë nga veprimtaria informative parandaluese, në përputhje me legjislacionin për përgjimin parandalues.

Neni 38

Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave personale për qëllime policore

1. Të dhënat personale të mbledhura për qëllime policore përdoren vetëm për atë qëllim dhe për atë kohë sa janë të domosdoshme, duke respektuar dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat personale fshihen kur vërtetohet se personi nuk është autor i veprës penale ose bëhen anonime kur ato nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur.

2. Rregullat e trajtimit të të dhënave personale të mbledhura nga policia, të administrimit e të shpërndarjes së tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3. Policia është e detyruar t'i përgjigjet me shkrim çdo kërkuar që pretendon se policia i ka shkelur të drejtat e tij për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këto raste përgjigja jepet sa më shpejt, por jo më vonë se 30 ditë nga depozitimi i kërkesës ose ankesës. Kërkuar ka të drejtën e ankimit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Ndalohet mbledhja e të dhënave të individëve dhe subjekteve vetëm për shkak se i përkasin një race, etnie, ngjyre, bindjeje politike, fetare, filozofike, identiteti gjinor, orientimi seksual të caktuar, apo për shkak të karakteristikave të seksit, jetesës me HIV/AIDS, si dhe për shkak se i përkasin një lëvizjeje ose organizate, kur nuk parashikohet me ligj.

Neni 39

Detyrimi i institucioneve shtetërore e private për dhënie informacioni dhe akses i policisë në bazat e të dhënave të tyre

1. Policia e Shtetit, në ushtrim të kompetencave të saj, siguron të dhëna nga akses i garantuar me ligj ose me marrëveshje në bazat e të dhënave të institucioneve shtetërore, agjencive dhe subjekteve private për identitetin e shtetasve, regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shtetasve apo subjekteve tregtare, për regjistrimin e automjeteve dhe lejeve të drejtimit, për subjektet tregtare dhe për eksportet apo importet e tyre, për identitetin e abonentëve telefonikë, identifikimin e pajisjes fundore dhe vendndodhjen.

2. Organet e administratës publike, personat fizikë dhe juridikë, që administrojnë të dhëna dhe informacione të mbledhura në mënyrë të ligjshme dhe të vlefshme për ushtrimin e funksioneve policore, janë të detyruar t'i paraqesin ato, kur u kërkohej nga policia, përjashtuar të dhënat, shpërndarja e të cilave është e ndaluar me ligj.

3. Gjatë përmblotjes së funksioneve të saj, policia respekton parimet dhe rregullat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Procedurat për aksesin, njohjen dhe përpunimin e të dhënave të përcaktuara në këtë nen nga ana e policisë miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

5. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, veprimtarinë e grumbullimit, të përpunimit, të shpërndarjes dhe të shkëmbimit të këtyre të dhënave.

Neni 40

Bashkëpunimi i fshehtë me individë

1. Policia vendos marrëdhënie të fshehta bashkëpunimi me individë për t'u informuar për çështje që lidhen me mbrojtjen e rendit e të sigurisë publike ose për parandalimin, zbulimin dhe goditjen e veprave penale.

2. Punonjësi i policisë ka detyrimin të ruajë fshehtësinë e identitetit, si dhe të rrethanave të tjera që mund të çojnë në identifikimin e personit, që bashkëpunon në mënyrë të fshehtë me policinë, edhe në rastet kur thirret si dëshmitar në gjykatë, si dhe pas largimit nga funksioni apo pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me policinë.

3. Çdo person, që i jep informacion policisë, ka të drejtën e anonimitetit, përveç rasteve kur marrëveshja ndërmjet palëve dhe detyrimet e legjislacionit procedural penal parashikojnë ndryshe.

4. Rregullat për vendosjen e bashkëpunimit të fshehtë përcaktohen me udhëzim të ministrit.

5. Procedurat e bashkëpunimit dhe përcaktimit të mënyrave e të formave të garantimit të shtetasit, në rastet e regjistrimit të procedimit penal, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit, Prokurorit të përgjithshëm dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Neni 41

Përpunimi dhe administrimi i informacionit policor

1. Përpunimi i informacionit policor është mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, deklarimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njehsimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi, për nevoja të mbrojtjes së rendit e të sigurisë publike ose për nevoja të parandalimit e zbulimit të veprave penale.

2. Përpunimi i informacionit policor bazohet vetëm në të dhënat e marra në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Për fshirjen, asgjësimin apo bërjen anonim të informacionit policor ngrihet dhe funksionon një komision i posaçëm, i cili ushtron funksionin e tij me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për asgjësimin e informacionit të klasifikuar.

4. Rregullat konkrete për realizimin e përpunimit të informacionit policor prej strukturave përkatëse, si dhe masat për ruajtjen e të dhënave e për kontrollin e kësaj veprimtarie informative përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 42

Transmetimi i të dhënave personale te palët e treta

1. Transmetimi i të dhënave me agjencitë e tjera ligjzbatuese lejohet vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për raste të tjera, transmetimi mund të kryhet kur është i domosdoshëm për parandalimin e një rreziku serioz potencial apo kur subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij.

2. Të dhënat e transmetuara nuk mund të përdoren për qëllime të tjera përveç atyre për të cilat ato janë marrë. Policia jep pëlqimin për shpërndarjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 43

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave

1. Për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale drejt vendeve që kanë apo nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, zbatohen dispozitat dhe rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Transferimi i të dhënave tek autoritetet e huaja kufizohet vetëm për organet policore dhe është i lejueshëm vetëm nëse:

a) ekziston një dispozitë ligjore në legjislacionin kombëtar dhe në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë;

b) në mungesë të kësaj dispozite, transferimi është i nevojshëm për parandalimin, hetimin, zbulimin e veprave penale ose për zbatimin e ndëshkimeve penale dhe shteti marrës duhet të garantojë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje për përpunimin e të dhënave personale;

c) në përjashtim nga rregulli i mësipërm, transferimi është i nevojshëm për parandalimin e një krimi.

3. Përshtatshmëria e nivelit të mbrojtjes, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bazë të rrethanave në të cilat ndodhet procesi i transferimit të të dhënave.

Neni 44

Siguria dhe konfidencialiteti

1. Policia merr masa organizative dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave personale nga shkatërrimi i paligjshëm ose aksidental, aksesit ose përhapja te persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave kryhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër përpunimi të paligjshëm.

2. Çdo person, që ka akses në të dhënat personale të mbledhura, të ruajtura dhe të përpunuara nga policia, gjatë ushtrimit të detyrës i nënshtrohet detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit edhe pas përfundimit të ushtrimit të funksioneve të tyre, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

Neni 45

Të drejtat e subjektit të të dhënave personale

1. Çdo person ka të drejtë që pa pagesë të kërkojë me shkrim informacion për të dhënat personale, që përpunohen nga Policia.

2. Kërkesa refuzohet në rast se ky refuzim është i nevojshëm për të bërë të mundur që Policia të përmbushë detyrat e saj.

3. Çdo person ka të drejtë të kërkojë nga policia korrigjimin apo fshirjen e të dhënave të pasakta në lidhje me të.

4. Në çdo rast, policia i kthen përgjigje me shkrim subjektit brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

KREU IV

ORGANIZIMI I POLICISË SË SHETIT

Neni 46

Organizimi i Policisë së Shtetit

(Shtuar pika 2/1, shfuqizuar pikat 3 dhe 4, ndryshuar pika 6 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Policia e Shtetit është e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor. Ajo organizohet e profilizuar mbi bazë shërbimi, për hetimin e krimit, për rendin dhe sigurinë publike, si dhe për kufirin dhe migracionin, të cilat ndryshojnë nga arsimi, kualifikimi, simbolet, detyrat dhe përgjegjësitë që ushtrojnë.

2. Policia e Shtetit organizon shërbimet e saj bazuar në madhësinë dhe numrin e popullsisë së zonave administrative dhe në numrin e popullsisë, nivelin e kriminalitetit, karakteristikat gjeografike të zonës dhe veçoritë e rrjetit të komunikacionit. Në këtë proces, ajo merr në konsideratë ndarjen territoriale e administrative, hartën gjyqësore, si dhe organizimin e sektorëve të ndryshëm infrastrukturorë, si: portet, aeroportet, akset rrugore ose duke vlerësuar objektiva të tjerë ekonomiko-socialë dhe rëndësinë e tyre.

2/1. Shërbimet e Policisë së Shtetit organizohen në departamente, drejtori qendrore dhe vendore, struktura të veçanta, struktura tekniko-shkencore, teknologjike dhe të informacionit, komisariate, sektorë, njësi dhe stacione policore, që e ushtrojnë veprimtarinë në nivel qendror dhe vendor sipas shpërndarjes territoriale, në varësi të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Policia e Shtetit garanton që këto shërbime të mbështeten me kapacitete njerëzore, financiare, administrative, operacionale dhe logjistike për ushtrimin e shërbimeve policore në secilin nivel organizativ.

3. Shfuqizuar.

4. Shfuqizuar.

5. Struktura e përgjithshme e Policisë së Shtetit, ku bëjnë pjesë Drejtoria e Përgjithshme, departamentet dhe struktura përgjegjëse për funksionet horizontale, strukturat e veçanta, drejtoritë vendore deri në nivel komisarati, miratohen me urdhër të Kryeministrit.

6. Numri i personelit të Policisë së Shtetit miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit.

7. Organizimi i brendshëm dhe kompetenca lëndore e territoriale e strukturave policore, të përcaktuara në pikën 6, dhe strukturave të tjera të Policisë së Shtetit, miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 47

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është strukturë qendrore, administrative dhe teknike e policisë, me seli në Tiranë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit përgjigjet, për:

a) ndjekjen dhe analizimin e situatës së rendit e të sigurisë publike në vend dhe të fenomeneve e formave kryesore që e kërcënojnë atë;

b) planifikimin, bashkërendimin dhe koordinimin e veprimtarisë së shërbimeve e strukturave policore;

c) përgatitjen e planeve të zhvillimit të shërbimeve policore dhe hartimin e kërkesave për modernizimin e tyre, si dhe të programeve të veçanta në fushën e rendit e të sigurisë publike;

ç) planifikimin dhe rekrutimin e personelit në Policinë e Shtetit dhe menaxhimin e burimeve njerëzore;

d) përcaktimin e prioritetëve për zhvillimin profesional të personelit policor, planifikimin e nevojave për formimin e tyre, si dhe të drejtimeve të kërkimit shkencor e teknologjik në fushën e rendit e të sigurisë publike;

dh) propozimin dhe menaxhimin e buxhetit, burimeve të tjera materiale e financiare dhe infrastrukturës së Policisë Shtetit që ka në administrim;

e) koordinimin me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe struktura shtetërore me përgjegjësi në ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale dhe sigurinë kombëtare;

ë) zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare për çështje që lidhen me bashkëpunimin policor;

f) përpunimin dhe analizën e të dhënave të mbledhura nga strukturat e policisë dhe të statistikave zyrtare shtetërore në fushën e rendit e sigurisë publike;

g) përgatitjen e studimeve e vlerësimeve, hartimin në mënyrë periodike të analizave të riskut dhe analizave të tjera në fushat e shërbimeve dhe veprimtarive policore;

gj) informimin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet medias në lidhje me ngjarje, fenomene dhe veprimtari që kanë të bëjnë me fushat e përgjegjësisë saj dhe janë me interes për publikun;

h) realizimin e koordinimit për angazhimin e strukturave policore në raste të emergjencave, aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare;

i) bashkëpunimin me strukturat kombëtare, ndërkombëtare, si dhe organizatat jofitimprurëse që kanë për mision monitorimin e standardeve të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut;

j) njoftimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për llojin e të dhënave që krijon dhe administron policia, për qëllimin e këtij ligji;

k) kryerjen e detyrave të tjera për administrimin e Policisë së Shtetit, në përputhje me këtë ligj, ligje të tjera dhe aktet në zbatim të tyre.

Neni 48

Departamenti

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Departamenti është strukturë administrativo-operacionale dhe organizohet në nivel qendror.

2. Departamenti kryen veprimtari administrative, operationale dhe hetimore.

3. Departamentet drejtohen nga drejtorët dhe janë në varësi të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 49

Drejtoria vendore

(Ndryshuar pika 1 dhe 3 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Drejtoria vendore është strukturë administrative dhe operationale e Policisë së Shtetit në nivel vendor.

2. Drejtoria vendore e policisë kryen veprimtari operacionale dhe hetimore mbi baza territoriale dhe lëndore, mbikëqyr dhe kontrollon kryerjen e detyrave, si dhe bashkërendon veprimtarinë e strukturave në varësi.

3. Drejtoria vendore e policisë përbëhet nga komisariate, stacione dhe posta policore.

Neni 50

Komisariati

(Ndryshuar me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

Komisariati i policisë është strukturë bazë administrative, operacionale dhe hetimore në varësi të drejtorisë vendore dhe ushtron përgjegjësitë e policisë në territorin që ka në juridiksion.

Neni 51

Stacioni i policisë dhe posta policore

(Ndryshuar me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

Stacioni i policisë është njësi policore administrative, operacionale dhe hetimore në varësi të komisarariatit ose në raste të veçanta, kur nuk ka komisarariat, në varësi të drejtorisë vendore të policisë. Stacionet mund të jenë të përhershme ose të përkohshme. Në varësi të dinamikës së lëvizjeve demografike dhe sezoneve turistike ngrihet postë policore e përhershme ose e përkohshme.

Neni 52

Strukturat e veçanta

1. Strukturat e veçanta ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e vendit ose në pjesë të veçanta të tij dhe janë në varësi të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit ose drejtorit të departamentit.

2. Strukturat e veçanta janë shërbime policore të specializuara për të kryer:

a) detyra specifike;

b) detyra për operacione policore të një shkalle të lartë vështirësie, të cilat nuk mund të përballohen nga shërbimet e Policisë së Shtetit.

Neni 53

Instituti i Policisë Shkencore

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Instituti i Policisë Shkencore është një strukturë e veçantë në varësi administrative të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, funksioni i të cilit është të mbështesë sistemin e drejtësisë dhe procesin e hetimit përmes mbledhjes së provave në skenën e krimit, ekspertizës kriminalistike cilësore, të paanshme dhe të besueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, metodat shkencore bashkëkohore dhe standardet ndërkombëtare në fushën e kriminalistikës.

2. Statusi, organizimi, funksionimi dhe trajtimi i punonjësve të Institutit të Policisë Shkencore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Brendshëm.

**KREU V
AUTORITETET**

Neni 54

Ministri

1. Ministri është autoriteti përgjegjës për rendin e sigurinë publike, i cili, nën përgjegjësinë e tij dhe brenda drejtimeve kryesore të politikës shtetërore, përcakton drejtimit e veprimtarisë e të mbështetjes së Policisë së Shtetit në përmbushjen e misionit dhe të përgjegjësiave të saj.

2. Ministri:

a) përcakton drejtimit strategjike, politikat, objektivat dhe treguesit e performancës për veprimtarinë e policisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) miraton dhe mbikëqyr menaxhimin e buxhetit të policisë, sipas legjislacionit financiar;

c) është përgjegjës për drejtimit e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e rendit e të sigurisë publike, në përputhje me traktatet dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare;

ç) ushtron kontroll administrativ mbi Policinë e Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) mbikëqyr procesin e ankimeve në Policinë e Shtetit dhe shqyrton ankesat ndaj drejtorit të përgjithshëm të Policisë.

3. Ministri nuk ndërhyr në pavarësinë operacionale të Policisë së Shtetit dhe nuk përfshihet në drejtimin operacional të saj.

4. Ministri i ushtron përgjegjësitë e tij në fushën e rendit e të sigurisë publike përmes strukturave në Ministrinë e Brendshme.

Neni 55

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit

1. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit është autoriteti më i lartë i policisë dhe përgjigjet drejtpërdrejt te ministri për realizimin e politikave, të performancës e të objektivave të përcaktuar.

2. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit:

a) organizon, drejton e kontrollon veprimtarinë e policisë;

b) drejton përgatitjen e krijimin e kapaciteteve të shërbimeve policore dhe garantimin e efektivitetit të tyre në përmbushjen e përgjegjësiave;

c) menaxhon burimet njerëzore;

ç) siguron mbështetjen logjistike, administrative dhe atë me sisteme teknologjike të shërbimeve policore;

d) garanton që sistemi i vlerësimit të personelit të policisë dhe ai i përparimit në karrierë janë efektivë dhe në përputhje me politikat e standardet e miratuara;

dh) i propozon ministrit kërkesat buxhetore për policinë dhe, pas miratimit, është përgjegjës për menaxhimin e buxhetit;

e) i propozon ministrit planet e zhvillimit të shërbimeve policore, kërkesat për modernizimin e tyre, si dhe programe të veçanta në fushën e rendit e të sigurisë publike;

ë) miraton koncepte, doktrina dhe procedura me të cilat operojnë shërbimet e strukturat policore;

f) promovon dhe drejton kërkimin shkencor e teknologjik mbi policimin;

g) informon ministrin kur ka pamundësi objektive në arritjen e rezultateve të përcaktuara;

gj) njofton menjëherë ministrin nëse konstaton cenime kritike në integritetin institucionit dhe të punonjësve, si dhe për situata apo rrethana, që mund të shkaktojnë vëmendje publike;

h) koordinon veprimet e policisë në rast emergjencash kombëtare ose ndërkombëtare, duke përfshirë mbrojtjen e infrastrukturës kritike;

i) përfaqëson policinë në marrëdhënie me institucionet e tjera brenda vendit, si dhe në marrëdhëniet teknike dy ose shumëpalëshe me jashtë;

j) përgatit raportin vjetor mbi arritjet e policisë dhe identifikon fushat policore që kanë nevojë për përmirësim për ministrin;

k) lëshon certifikata dhe medalje për shërbime të dalluara të punonjësve të policisë dhe certifikatën e karrierës sipas rregullores së policisë;

l) nxjerr akte administrative brenda detyrave dhe përgjegjësiave që ka dhe ato të përcaktuara në rregulloren e policisë;

ll) ushtron detyra dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit

(Ndryshuar pika 9 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

2. Ministri i propozon Këshillit të Ministrave kandidatin për drejtor të përgjithshëm të Policisë së Shtetit pas kryerjes së një procesi të konkurrimit të hapur, të bazuar në parimet e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimit. Rregullat e procedurat për përzgjedhjen e kandidatit për drejtor të përgjithshëm të Policisë së Shtetit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

3. Kandidati i propozuar për drejtor të përgjithshëm të Policisë së Shtetit duhet të jetë njëri nga punonjësit e policisë që, më së paku, mban njërën nga gradat e rolit të mesëm drejtues e që plotëson këto kritere:

a) të ketë shtetësi shqiptare;

b) të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) të mos ketë marrë masat disiplinore të përcaktuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 123, brenda 5 (pesë) vjetëve të fundit;

ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

d) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.

4. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit qëndron në detyrë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, me të drejtë riemërimi, sipas rregullave të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, edhe për një mandat të dytë.

5. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit pezullohet nga detyra me urdhër të ministrit kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit.

6. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit lirohet nga detyra, kur:

a) humbet shtetësinë shqiptare;

b) i përfundon afati i qëndrimit në detyrë dhe nuk riemërohet;

c) jep dorëheqjen;

ç) bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për ushtrimin e funksionit për një periudhë kohore mbi 6 (gjashtë) muaj;

d) plotëson moshën për pension;

dh) i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

7. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit shkarkohet nga detyra kur:

a) dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

b) nuk përmbush objektivat strategjike ose ka performancë të ulët.

8. Lirimi dhe shkarkimi i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

9. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit pas lirimit nga detyra rikthehet në strukturat e Policisë së Shtetit dhe i jepet grada “Drejtues i Parë” pa të drejtë riemërimi si drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Në interes të shërbimit të rendit dhe të sigurisë publike, ai mund të kryejë funksione drejtuese, këshillimore, pedagogjike ose të atashohet si oficer kontakti. Me përfundimin e qëndrimit në detyrë, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit gëzon trajtim të veçantë, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

1. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në ushtrimin e përgjegjësisë së tij, mbështetet nga Këshilli i Policisë së Shtetit, organ këshillimor, i cili krijohet e funksionon në interes të vendimmarrjes së tij.

2. Këshilli i Policisë së Shtetit kryesohet nga zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe, në varësi të çështjeve që do të trajtohen, përbëhet nga drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive vendore (me rotacion çdo vit), drejtuesi i Akademisë së Sigurisë, si dhe mund të ftohen drejtues të strukturave përkatëse të policisë apo përfaqësues të sindikatës së punonjësve të policisë, sipas objektit të çështjeve që do të trajtohen.

3. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit e mbledh Këshillin e Policisë së Shtetit sa herë shqyrtohen e diskutohen çështje me rëndësi në menaxhimin dhe drejtimin e veprimtarisë së policisë, siç janë raportit vjetor i Policisë së Shtetit, planet e Policisë për zbatimin e strategjive, nevojat dhe hartimi i kërkesave buxhetore, planet e modernizimit, projektakte në interes të hartimit të strategjive sektoriale dhe roli, detyrat e përgjegjësitë në përmbushjen e këtyre prioritetëve strategjike, riorganizimet e strukturave të Policisë së Shtetit, projektakte të rëndësishme për rregullimin e veprimtarisë së policisë dhe çështje të tjera për të cilat kërkohet konsultim i gjerë.

4. Këshilli i Policisë së Shtetit vendos me shumicë votash dhe nxjerr një relacion me rekomandime lidhur me çështjet e diskutuara në rendin e ditës, që i paraqitet drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

5. Procedurat e hollësishme të krijimit dhe të funksionimit të Këshillit të Policisë së Shtetit përcaktohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë.

Neni 58

Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit (Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, mbështetet nga një zëvendësdrejtor i përgjithshëm.

2. Zëvendësdrejtori kryen detyrat që i delegohen nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

3. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit ushtron kompetencat dhe detyrat e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit:

a) kur nuk është emëruar ende;

b) në mungesë të tij;

c) në rast paaftësie ose pezullimi nga detyra të tij.

4. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit nuk mund të ushtrojë kompetencat e drejtorit për një periudhë të pandërprerë më shumë se 6 (gjashtë) muaj.

Neni 59

Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit (Ndryshuar fjalia e dytë e pikës 2 dhe pika 4 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit emërohet njëri nga punonjësit e policisë që, më së paku, mban njërën nga gradat e rolit të mesëm drejtues e që plotëson këto kritere:

a) të ketë shtetësi shqiptare;

b) të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një veprë penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) të mos ketë marrë masat disiplinore të përcaktuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 123, brenda 5 (pesë) vjetëve të fundit;

ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

d) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.

2. Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit bëhet me urdhër të ministrit, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Drejtori i

përgjithshëm i propozon ministrit kandidatin e zgjedhur bazuar në parimet e mundësive të barabarta, të meritokracisë dhe të mosdiskriminimit. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për zëvendës drejtor të përgjithshëm të Policisë së Shtetit përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

3. Zëvendës drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit pezullohet nga detyra me urdhër të ministrit kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit.

4. Rastet e lirimit e të shkarkimit, si dhe mandati i qëndrimit në detyrë për zëvendës drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit janë të njëjta me ato të drejtorit të departamentit.

Neni 60

Drejtori i departamentit, përgjegjësitë, kriteret e emërimit, të lirimit e të shkarkimit të tij

(Ndryshuar pika 1, shkronja ‘c’ e pikës 3 dhe pika 5 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Drejtori i departamentit është autoriteti më i lartë i shërbimit policor të departamentit që drejton.

2. Drejtori i departamentit përgjigjet te drejtori i përgjithshëm i Policisë për menaxhimin dhe veprimtarinë e departamentit që drejton dhe, kur kërkohet, edhe te ministri.

3. Drejtori i departamentit:

a) drejton dhe koordinon veprimtarinë e strukturave në varësi të tij;

b) propozon dhe menaxhon kapacitetet njerëzore e logjistike në departamentin që drejton;

c) propozon buxhetin e departamentit që drejton;

ç) propozon nevojat për përmirësimin dhe modernizimin e sistemeve në përdorim nga departamenti që drejton;

d) i propozon drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit organizimin strukturor të departamentit dhe emërimet, shkarkimet e transferimet e punonjësve të departamentit që drejton;

dh) nxjerr akte të përcaktuara në rregulloren e policisë, që lidhen me veprimtarinë e departamentit;

e) bashkëpunon me drejtuesit e strukturave qendrore dhe vendore brenda juridiksionit dhe fushës përkatëse të kompetencës, me qëllim realizimin e objektivave të shërbimit policor që ai drejton;

ë) krijon marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi për koordinimin e veprimtarive operacionale dhe mbështetjen administrative me strukturat e tjera qendrore, me prokurorinë, institucionet e tjera të administratës publike, me organizata qeveritare e joqeveritare, si dhe me komunitetin;

f) kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar ose të përcaktuar nga akte ligjore, nënligjore dhe akte të tjera.

4. Drejtori i departamentit përzgjidhet nga radhët e punonjësve të policisë të rolit të mesëm drejtues nëse plotëson njëkohësisht kriteret si më poshtë:

a) të ketë shtetësi shqiptare;

b) të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore të policisë brenda 3 (tre) vjetëve të fundit;

ç) të jetë në kushte shëndetësore, që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

d) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.

5. Drejtori i departamentit emërohet, lirohet ose shkarkohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dhe qëndron në detyrë për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rikundërimi edhe për një mandat të dytë. Drejtori i përgjithshëm i propozon ministrit kandidatin për drejtor departamenti pas kryerjes së një procesi konkurrimi të hapur, të bazuar në parimet e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimit. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për drejtor departamenti përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

6. Rastet e lirimit dhe të shkarkimit të drejtorit të departamentit janë të njëjta me ato të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 61

Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, përgjegjësitë, kriteret e emërimit, të shkarkimit e të lirimit të tij

(Ndryshuar pika 1, paragrafi I parë I pikës 3 dhe pika 4 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë është autoriteti më i lartë ekzekutiv, administrativ dhe operacional i policisë në nivel vendor dhe përgjigjet te drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

2. Drejtori i Drejtorisë Vendore, brenda juridiksionit të tij:

- a) drejton dhe koordinon veprimtarinë e strukturave;
- b) menaxhon burimet njerëzore në varësi;
- c) menaxhon buxhetin;
- ç) nxjerr akte të përcaktuara në rregulloren e Policisë;
- d) bashkëpunon me drejtuesit e strukturave vendore, brenda juridiksionit dhe të fushës përkatëse të kompetencës, me qëllim përmirësimin e policimit dhe sigurinë e komunitetit.

3. Drejtori i Drejtorisë Vendore përzgjidhet nga radhët e rolit të mesëm drejtues, nëse plotëson njëkohësisht kriteret si më poshtë:

- a) të ketë shtetësi shqiptare;
- b) të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore të policisë brenda 3 (tre) vjetëve të fundit;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.

4. Drejtori i Drejtorisë Vendore emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

5. Procedura e konkurrimit të drejtorit të Drejtorisë Vendore përcaktohet në rregulloren e Policisë së Shtetit.

6. Drejtori i Drejtorisë Vendore qëndron në detyrë për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh, me të drejtë rikonkurrimi edhe për një mandat të dytë.

7. Rastet e lirimit dhe të shkarkimit nga detyra të drejtorit të Drejtorisë Vendore janë të njëjta me ato të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 62

Shefi i komisariatit, përgjegjësitë, kriteret e emërimit, të lirimit dhe të shkarkimit të tij

(Ndryshuar pikat 3, 4 dhe shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Shefi i komisariatit të policisë është drejtues i nivelit operacional në territorin që mbulon dhe përgjigjet te drejtori i policisë vendore për rendin e sigurinë publike në juridiksionin e komisariatit të policisë.

2. Shefi i komisariatit të policisë:

- a) drejton veprimtarinë e strukturave në varësi;
- b) menaxhon burimet njerëzore në varësi;
- c) menaxhon buxhetin e komisariatit;
- ç) nxjerr akte të përcaktuara në rregulloren e Policisë.
- d) bashkëpunon me drejtuesit e strukturave vendore brenda juridiksionit dhe të fushës përkatëse të kompetencës, me qëllim përmirësimin e policimit dhe sigurinë e komunitetit.

3. Shefi i komisariatit përzgjidhet nga radhët e punonjësve të policisë që mbajnë gradën “komisar” ose “kryekomisar” dhe plotësojnë kriteret si më poshtë:

- a) të ketë shtetësi shqiptare;
- b) të mos ketë masa në fuqi për shkelje të rënda disiplinore të policisë;
- c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- ç) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.

3/1. Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i tij bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

4. Procedurat e përzgjedhjes së shefit të komisarariatit të policisë përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

KREU VI GRADAT

Neni 63 **Sistemi i gradave**

1. Sistemi i gradave përcakton hierarkinë, rolin dhe nivelin e menaxhimit në përmbushjen e përgjegjësiave të Policisë së Shtetit.

2. Sistemi i gradave, sipas këtij ligji, paraqitja, forma, emërtimet dhe mbajtja e tyre janë e drejtë vetëm e Policisë së Shtetit.

Neni 64 **Hierarkia e menaxhimit policor**

Gradat në polici ndahen në role sipas kompetencës së veprimit e të nivelit të menaxhimit si më poshtë:

- a) në rolin zbatues, ku përfshihen punonjësit e policisë, që përfaqësojnë nivelin bazë të veprimit policor;
- b) në rolin e parë drejtues, ku përfshihen punonjësit e policisë, që përfaqësojnë nivelin e ulët të menaxhimit dhe veprimin teknik e operacional;
- c) në rolin e mesëm drejtues, ku përfshihen punonjësit e policisë, që përfaqësojnë nivelin e mesëm të menaxhimit në strukturat qendrore, si dhe ato vendore;
- ç) në rolin madhor, ku përfshihen punonjësit e policisë, që përfaqësojnë nivelin e lartë të menaxhimit.

Neni 65 **Emërtimi i gradave**

1. Gradat në Policinë e Shtetit, sipas rendit hierarkik rritës, ndahen në grada të rolit zbatues, në rolin e parë drejtues, në rolin e mesëm drejtues dhe në rolin madhor.

2. Grada për punonjësit e rolit zbatues është inspektor.

3. Gradat për punonjësit në rolin e parë drejtues janë:

- a) nënkomisar;
- b) komisar;
- c) kryekomisar.

4. Gradat për punonjësit në rolin e mesëm drejtues janë:

- a) drejtues;
- b) drejtues i parë.

5. Gradat për punonjësit në rolin madhor janë:

- a) drejtues i lartë;
- b) drejtues madhor.

6. Kalimi nga grada në gradë bëhet në mënyrë të njëpasnjëshme sipas hierarkisë së tyre, vetëm pasi punonjësi i policisë ka fituar në një proces konkurrimi, si dhe ka kaluar me sukses programin e formimit përkatës për gradën pasardhëse.

7. Autoriteti përgjegjës për vlerësimin e përparimit të punonjësve të policisë në karrierë janë komisionet e vlerësimit. Përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit të tyre përcaktohen në rregulloren e Policisë.

Neni 66

Hierarkia e gradave dhe përcaktimi i funksioneve për gradë

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Hierarkia e punonjësve të policisë përcaktohet nga funksioni, nga grada për punonjësit me të njëjtin funksion dhe nga vjetërsia në gradë për punonjësit me gradë e funksion të njëjtë.

2. Çdo funksioni i caktohet grada korresponduese. Numri dhe tabela e funksioneve korresponduese për çdo gradë dhe kategorizimi i tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 67

Paraqitja e gradave

Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të gradave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VII

PRANIMI, FORMIMI DHE ECURIA NË KARRIERË

Neni 68

Personeli në Policinë e Shtetit

Personeli në Policinë e Shtetit përbëhet nga:

a) punonjës që ushtrojnë funksione policore dhe që janë përgjegjës për përmbushjen e përgjegjësi të Policisë së Shtetit, sipas këtij ligji, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet sipas dispozitave të këtij ligji;

b) nëpunës civilë, që janë përgjegjës për ushtrimin e autoritetit administrativ, publik, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet sipas legjislacionit për nëpunësin civil;

c) punonjës administrativë, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet sipas parashikimeve në Kodin e Punës.

ç) personeli akademik, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet sipas parashikimeve në legjislacionin për arsimin e lartë.

Neni 69

Kategoritë e pranimit në rolet policore

(Ndryshuar shkronjat "a/ii" dhe "b/iii" të pikës 1 dhe shtuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Pranimi në rolet policore, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj, bëhet nga këto kategori:

a) në rolin zbatues pranohen:

i. shtetas që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë;

ii. punonjës nga institucionet e tjera të sigurisë, që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe shkollën në Kolegjin Profesional të Formimit Policor në Akademinë e Sigurisë ose të njësuar me të dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara;

b) në rolin e parë drejtues pranohen:

- i. punonjës të Policisë së Shtetit të rolit zbatues nëpërmjet konkurrimit;
 - ii. shtetas që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë;
 - iii. punonjës nga institucionet e tjera të sigurisë, që kanë përfunduar arsimin e lartë dhe shkollën në Kolegjin Profesional të Formimit Policor në Akademinë e Sigurisë ose të njësuar me të dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara;
 - iv. punonjës i Policisë i rolit zbatues me arsim të lartë nëpërmjet konkurrimit;
 - v. shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë në profilet e përcaktuara në rregulloren e Policisë së Shtetit.
2. Mosha për secilën kategori të pranimeve përcaktohet me urdhër të ministrit.
 3. Punonjësit e pranuar sipas këtij neni i nënshtrohen trajnimit të detyruar 2-javor në Akademinë e Sigurisë.
 4. Rregullat dhe procedurat e pranimi sipas këtij neni përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

Neni 70

Kriteret e përgjithshme për aplikimin për pranimin si punonjës policie

Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar si punonjës policie shtetasit që plotësojnë këto kriteret të përgjithshme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit, strukturat e tjera të sigurisë kombëtare apo të jetë larguar nga shërbimi civil me masë disiplinore;
- ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;
- d) të ketë mbaruar arsimin e mesëm të lartë;
- dh) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Neni 71

Pranimi në rolin zbatues në polici nëpërmjet konkurrimit

1. Pranimi në rolin zbatues në Policinë e Shtetit bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur për shtetas, që plotësojnë kriteret e përgjithshme të pranimi.
2. Programi i formimit bazë dhe i profilizimit policor për punonjësit e rolit zbatues zhvillohet sipas kohëzgjatjes e përcaktimeve nga Akademia e Sigurisë. Pas përfundimit me sukses të tij, kursanti pranohet në Policinë e Shtetit dhe merr gradën inspektor.
3. Rregullat dhe procedurat e zhvillimit të konkurrimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 72

Pranimi në rolin zbatues në Policinë e Shtetit nga institucionet e tjera të sigurisë

(Shfuqizuar me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

Neni 73

Pranimi në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit nëpërmjet konkurrimit

1. Pranimi në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit bëhet me anë të konkurrimit në të njëjtën kohë të punonjësve të policisë së rolit zbatues dhe të shtetasve, që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë.
2. Kandidatët duhet të përmbushin kushtet dhe kriteret e përgjithshme të përcaktuara në nenin 70 të këtij ligji, kriteret për maturën shtetërore dhe kriteret e përcaktuara nga Akademia e Sigurisë për pranimin në programet e studimit.

3. Fituesit që pranohen nga jashtë sistemit policor, formimin bazë policor e kryejnë gjatë periudhës që ndjekin ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në Akademinë e Sigurisë. Të gjithë të diplomuarit në ciklin e parë të studimeve “Bachelor”, para emërimit në një funksion të caktuar në Policinë e Shtetit, duhet të përfundojnë me sukses programin e profilizimit.

4. Kohëzgjatja dhe struktura e programit të formimit bazë dhe programi i profilizimit përcaktohet nga Akademia e Sigurisë. Pas përfundimit me sukses të tyre, kandidati pranohet në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit dhe merr gradën “nënkomisar”.

5. Kuotat e pranimit për vitin akademik përcaktohen nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit në bazë të nevojave të Policisë së Shtetit për pranime në këtë rol policor dhe i përcillen Akademisë së Sigurisë për të ndjekur procedurat e certifikimit të tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin. Akademia e Sigurisë ndjek procedurat e konkurrimit e të vlerësimit të kandidatëve sipas legjislacionit në fuqi për pranimet në institucionet e arsimit të lartë dhe të këtij ligji për çështje të veçanta në lidhje me pranimin në Policinë e Shtetit.

6. Punonjësit e policisë të rolit zbatues, që pranohen në ciklin e parë të studimeve “Bachelor”, nuk llogariten si pjesë e numrit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ata janë të detyruar të përfundojnë studimet brenda periudhës së parashikuar 3-vjeçare. Gjatë kësaj periudhe, punonjësit që janë pranuar në ciklin e parë të studimeve “Bachelor” përfitojnë një bursë shkollimi të barabartë me pagën për gradë të inspektorit. Shpenzimet e studimeve të tyre mbulohen nga buxheti i Policisë së Shtetit.

7. Pas përfundimit me sukses të studimeve në ciklin e parë të studimeve “Bachelor” të Akademisë së Sigurisë, punonjësit e policisë kanë detyrimin e qëndrimit në detyrë të paktën edhe 3 (tre) vjet të tjerë.

8. Për shkaqe objektive, studentit i jepet e drejta të kërkojë zgjatjen e afatit të përfundimit të studimeve. Procedurat për zgjatjen e këtij afati dhe trajtimi financiar i tij përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

9. Punonjësit, që nuk e përfundojnë me sukses ciklin e parë të studimeve “Bachelor” ose që nuk plotësojnë afatin e detyrueshëm të qëndrimit në detyrë, kanë detyrimin të kthejnë bursën e shkollimit, sipas pikës 6 të këtij neni.

Neni 74

Pranimi në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit nga institucionet e tjera të sigurisë *(Shfuqizuar me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)*

Neni 75

Pranimi në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit nga punonjësit e rolit zbatues me arsim të lartë

1. Për nevoja të Policisë së Shtetit, në rolin e parë drejtues pranohen punonjësit e policisë të rolit zbatues, që kanë përfunduar të paktën ciklin e parë të studimeve të arsimit të lartë në fushat kompjuterike, ekonomike ose juridike dhe që kanë qëndruar jo më pak se 5 (pesë) vjet në rolin zbatues.

2. Këta punonjës pranohen nëpërmjet konkurrimit për gradën “nënkomisar” sipas një procesi të përcaktuar në rregulloren e Policisë së Shtetit, pasi kanë përfunduar me sukses programin përkatës të formimit për rolin e parë drejtues.

3. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit shpall fazën e aplikimit dhe përcakton kuotat për këtë kategori që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

4. Përmbajtja dhe kohëzgjatja e programit përkatës për rolin e parë drejtues për këta punonjës përcaktohet nga Akademia e Sigurisë.

Neni 76

Pranimi në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit i shtetasve të diplomuar në ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë

1. Për nevoja të Policisë së Shtetit, në rolin e parë drejtues pranohen shtetas, që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në këtë ligj.

2. Kandidatët e diplomuar në ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, pas përfundimit me sukses të programit të formimit bazë në Akademinë e Sigurisë, pranohen në rolin e parë drejtues dhe marrin gradën “nënkomisar”.

3. Përmbajtja dhe kohëzgjatja e programit përkatës të formimit bazë policor për këta punonjës përcaktohet nga Akademia e Sigurisë pas vlerësimit të formimit arsimor dhe të kualifikimeve të tyre.

4. Fushat e formimit përkatës, mosha, nota mesatare për pranim, mënyra e shpalljes së thirrjeve dhe e vlerësimit të tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 77

Pranimi në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit i oficerëve të Policisë Gjyqësore (Shfuqizuar me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

Neni 78

Pranimi në funksione të veçanta (Ndryshuar pika 1 dhe shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Pranohen nëpërmjet procesit të konkurrimit në funksione të veçanta shtetasit të cilët, përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 70 të këtij ligji, plotësojnë kriteret e veçanta që lidhen me fushën e arsimit apo me aftësitë specifike në atë fushë dhe që disponojnë diploma, specializime ose kualifikime të cilat nuk përfitohen në programet e ofruara në Akademinë e Sigurisë.

1/1. Për pranimin në funksionet e veçanta, kandidati duhet të ketë jo më pak se 2 vjet përvojë pune në fushën përkatëse.

2. Fituesit e konkursit pranohen në Policinë e Shtetit vetëm pas përfundimit me sukses të programit të formimit, specializimit apo kualifikimit specifik dhe marrin gradën që i korrespondon funksionit të veçantë.

3. Personat e pranuar në funksione të veçanta nuk kanë të drejtë të aplikojnë për ngritje në gradë apo të transferohen në funksione të tjera policore për një periudhë 6-vjeçare.

4. Numri i personave të pranuar, sipas këtij neni, nuk mund të jetë më shumë se 3 për qind e limitit të përgjithshëm organik të Policisë së Shtetit.

5. Procedurat, rregullat e konkurrimit, transferimit brenda funksioneve të veçanta, si dhe funksionet e veçanta përcaktohen në rregulloren e Policisë.

Neni 79

Formimi i punonjësve të policisë

1. Policia e Shtetit e kryen formimin bazë, programet e studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë, programet e formimit profesional, si dhe programet e formimit të vazhduar të personelit të saj me gradë dhe civil në Akademinë e Sigurisë, si edhe të personelit të institucioneve të tjera të sigurisë.

2. Asnjë punonjës nuk mund të emërohet në një funksion të caktuar në Policinë e Shtetit pa ndjekur paraprakisht në Akademinë e Sigurisë programin përkatës të formimit ose atë të profilizimit për këtë funksion.

Neni 80

Formimi i vazhduar i punonjësit të policisë

1. Punonjësit e policisë i nënshtrohen trajnimit të detyrueshëm në shërbim sipas një programi të formimit të vazhduar, që synon të ruajë aftësitë dhe shprehitë e punonjësit në drejtim:

- a) të dhënies së ndihmës së parë;
- b) të aftësive fizike, përfshirë vetëmbrojtjen;
- c) të përdorimit të armës së zjarrit;
- ç) të njohjes me legjislacionin e përditësuar në fuqi.

2. Punonjësit e policisë, që në vlerësimin e aftësive për këta komponentë nuk arrijnë të marrin vlerësimin minimal të domosdoshëm për një apo disa prej tyre, dërgohen për përsëritjen e programit të formimit të vazhduar me qëllim që t'u jepet mundësia të fitojnë aftësitë teknike të kërkuara.

3. Punonjësit e policisë, që pas periudhës së përsëritjes së programit të formimit të vazhduar, brenda një afati 6-mujor nuk arrijnë të marrin vlerësimin minimal të kërkuar, lirohen nga Policia e Shtetit.

4. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit për punonjësit e çdo strukture policore, sipas rolit policor dhe moshës, përcaktohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 81

Akademia e Sigurisë

1. Akademia e Sigurisë është përgjegjëse për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, si dhe të personelit të strukturave të agjencive të tjera ligjzbatuese.

2. Akademia e Sigurisë ka liri akademike, autonomi financiare dhe organizative, sipas përcaktimit të ligjit për arsimin e lartë dhe organizohet e funksionon sipas parashikimeve të ligjit për arsimin e lartë dhe të këtij ligji.

3. Programet e studimit miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin sipas legjislacionit në fuqi, duke respektuar statusin e veçantë të Akademisë së Sigurisë.

4. Dëshmitë dhe certifikatat e përftuara në institucionet brenda dhe jashtë vendit në fushën e rendit e të sigurisë publike, në bazë të marrëveshjeve dhe që nuk mund të njihen e njësohen sipas legjislacionit për arsimin e lartë, njihen dhe njësohen në Akademinë e Sigurisë.

5. Organizimi dhe funksionimi i Akademisë së Sigurisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 82

Verifikimi i besueshmërisë

1. Studentët e pranuar në programet e formimit bazë ose në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Akademinë e Sigurisë, të cilët nuk janë punonjës të Policisë së Shtetit, i nënshtrohen verifikimit të besueshmërisë.

2. Verifikimi i besueshmërisë kryhet nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit në raport me të dhënat e regjistrave fizikë e elektronikë në administrim të Policisë së Shtetit, në regjistrat fizikë e elektronikë në të cilat Policia e Shtetit ka akses, si edhe në të dhëna të institucioneve të tjera ligjzbatuese kur është e nevojshme, duke respektuar parimin e transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit.

3. Procesi i verifikimit të besueshmërisë kryhet për të gjithë studentët e pranuar përpara fillimit të programit përkatës të studimit. Në rast se nga verifikimi i besueshmërisë rezulton se studenti ka lidhje të papërshtatshme me krimin e organizuar ose ka informacione që është i përfshirë në kryerjen e veprimtarive kriminale, vendoset përjashtimi i tij nga programi përkatës i formimit të Akademisë së Sigurisë.

4. Rregullat dhe procedurat për kryerjen e procesit të verifikimit të besueshmërisë përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

Neni 83

Baza e të dhënave të shenjave të gishtave dhe të ADN-së së punonjësve të policisë

1. Punonjësit të policisë i merren shenjat e gishtave, mostra e ADN-së dhe ato të balistikës së armës së shërbimit, duke u dokumentuar veprimi në praninë e tij, dhe ruhen në bazën e të dhënave të Policisë.

2. Shenjat e gishtave, mostra e ADN-së dhe ato të balistikës së armës së shërbimit, të administruara në bazën e të dhënave, asgjësohen kur punonjësi i policisë ndërpret marrëdhëniet e punës.

3. Rregullat dhe procedurat e marrjes, të administrimit e të asgjësimit të këtyre të dhënave përcaktohen në rregulloren e Policisë.

KREU VIII KARRIERA POLICORE

Neni 84

Emërimi i punonjësve të policisë

1. Propozimi për emërimin në detyrë të punonjësve të policisë bëhet nga Këshilli i Emërimeve, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në rregulloren e Policisë së Shtetit dhe me miratim të autoriteteve që përcakton ky ligj.

2. Këshilli i Emërimeve është i përhershëm dhe funksionon në dy nivele, atë qendror e vendor. Në nivel qendror funksionon Këshilli i Lartë i Emërimeve dhe në nivel vendor funksionon Këshilli Vendor i Emërimeve.

3. Këshilli i Lartë i Emërimeve i propozon drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit për emërimin në detyrë të punonjësit të policisë me gradë “komisar” deri “drejtues i parë”.

4. Këshilli Vendor i Emërimeve i propozon titullarit të strukturës vendore ose strukturës autonome për emërim në detyrë të punonjësit të policisë me gradë “inspektor” deri në “nënkomisar”.

5. Përbërja, funksionimi dhe kriteret e vlerësimit të Këshillave të emërimeve përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

Neni 85

Fitimi dhe dhënia e gradës

(Shtuar fjalia në fund të pikës 4 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Grada “inspektor” i jepet punonjësit të policisë nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit pas përfundimit të formimit bazë të policisë, në momentin e emërimit në detyrë.

2. Grada “nënkomisar” i jepet punonjësit të policisë nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit pas përfundimit të formimit bazë të policisë dhe konkurrimit apo kalimit të fazës së pranimit nga punonjësit jashtë sistemit policor.

3. Gradat nga “komisar” deri në “drejtues i parë” fitohen nëpërmjet konkurrimit për gradim.

4. Fitimi i gradave me konkurrim bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces aplikimi, verifikimi, vlerësimi konkurrues dhe pas përfundimit me sukses të programit përkatës të formimit. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit i jep punonjësit të policisë gradën pasuese mbi bazën e vlerësimit të demonstrimit të një profesionalizmi të lartë, të kryerjes së një akti me karakter heroik, të një veprimi që tejkalon pritshmëritë në situata të rrezikshme dhe të paparashikueshme apo të dhënies së kontributit të drejtpërdrejtë në garantimin e rendit dhe sigurisë publike, në shenjë mirënjohje dhe vlerësimi, me propozim të eprorit të punonjësit. Numri i gradave të dhëna sipas kësaj pike nuk mund të jetë më shumë se 2% e limitit të përgjithshëm të gradave policore.

5. Gradat “drejtues i lartë” dhe “drejtues madhor” jepen në momentin e emërimit të punonjësit në funksione, që i korrespondojnë këto grada.

6. Çdo vit evidentohen nevojat për çdo gradë për vitin pasardhës. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në varësi të nevojave dhe të prioriteteve, miraton urdhrin për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës përkatëse.

7. Fitimi i gradës bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë dhe vetëm për gradën pasardhëse.

8. Të drejtën për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit e kanë të gjithë punonjësit e policisë, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 86 të këtij ligji.
9. Grada “drejtues i lartë” jepet nga ministri.
10. Grada “drejtues madhor” jepet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 86

Kriteret e përgjithshme për ecurinë në gradë

(Ndryshuar nënndarjet “iii” dhe “iv” të shkronjës “dh” të pikës 1 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Ecuria në gradë e punonjësit të policisë bëhet nëpërmjet fitimit të njëpasnjëshëm të gradave, në përputhje me kriteret e përcaktuara për çdo gradë, si më poshtë:
 - a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës jo më të ulët se 70 për qind të vlerësimit të përgjithshëm, gjatë kohës së qëndrimit në gradë. Për marrjen e gradës “inspektor” llogaritet edhe vlerësimi i punës gjatë periudhës së provës;
 - b) të përmbushë kriteret për pozicionin e punës dhe të ketë përfunduar arsimin dhe kualifikimin përkatës për gradën për të cilën konkurron, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
 - c) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal;
 - ç) të mos ketë në fuqi masat disiplinore të përcaktuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 123 të këtij ligji;
 - d) të mos ketë filluar ndaj tij hetimi disiplinor për shkelje të rënda;
 - dh) të plotësojë kohën e qëndrimit në gradë, sipas afateve të mëposhtme:
 - i. nga “inspektor” në “nënkomisar” 5 vjet;
 - ii. nga “nënkomisar” në “komisar” 5 vjet;
 - iii. nga “komisar” në “kryekomisar” 4 vjet;
 - iv. nga “kryekomisar” në “drejtues” 4 vjet;
 - v. nga “drejtues” në “drejtues i parë” 5 vjet.
2. Punonjësi i policisë i rolit të mesëm drejtues merr gradën “drejtues i lartë” ose “drejtues madhor” në momentin e emërimit në funksionet korresponduese për këto grada, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Kur përfundon mandatin e plotë, sipas parashikimeve të këtij ligji, punonjësi i policisë, që ka mbajtur gradën “drejtues i lartë”, merr gradën “drejtues i parë”.
3. Konkurrimi për fitimin e gradës bëhet vetëm për gradën pasardhëse.
4. Në vjetërsinë për efekt konkurrimi për fitimin e gradës llogaritet edhe koha e ndërprerjes së karrierës për shkak:
 - a) të paaftësisë shëndetësore deri në 6 muaj brenda afatit 12-mujor;
 - b) të kohës së formimit kur nuk i kalon 6 muaj të pandërprerë gjatë vitit kalendarik;
 - c) të vjetërsisë së shërbimit të njohur me vendim gjyqësor;
 - ç) të lejes së lindjes.
5. Në vjetërsinë për efekt gradimi nuk llogaritet koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të lejes së përfituar pa të drejtë page.

Neni 87

Arsimimi dhe kualifikimet për fitimin e gradës

- Kurset e detyrueshme për fitimin e gradës përkatëse janë si më poshtë:
- a) për gradën “komisar” të ketë përfunduar kursin e formimit për komisar;
 - b) për gradën “kryekomisar” të ketë përfunduar kursin e formimit për kryekomisar;
 - c) për gradën “drejtues” të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të paktën në programin e studimit “Master profesional” në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;
 - ç) për gradën “drejtues i parë” të ketë përfunduar kursin e formimit për “drejtues të parë”.

Neni 88

Procedura për ecurinë në gradë

1. Aplikimi i punonjësit të policisë për fitimin e gradës i nënshtrohet procesit të verifikimit nga struktura qendrore e burimeve njerëzore.
2. Verifikimi i kandidatit përfshin plotësimin e kriterëve të përcaktuara në nenet 85, 86 e 87 të këtij ligji, gjatë fazës së aplikimit, të testimit dhe të formimit para fitimit të gradës.
3. Për fitimin e gradës “nënkomisar” deri në “komisar”, kandidati vlerësohet në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë.
4. Për fitimin e gradës “kryekomisar” deri në “drejtues i parë”, kandidati vlerësohet në testimin me shkrim, ushtrime vlerësuese dhe intervistë.
5. Kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit përkatës nuk mund të jetë më i ulët se 70 për qind e vlerës së përgjithshme të pikëve të testimit.
6. Punonjësi i policisë, për të fituar gradën “nënkomisar” dhe “drejtues”, duhet të përfundojë programin e studimit e të formimit përkatës, sipas parashikimeve të këtij ligji, ndërsa për fitimin e gradave të tjera duhet të përfundojë programin e formimit përkatës.
7. Në përfundim të procesit të konkurrimit dhe të vlerësimit, dhënia e gradës bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, bazuar në renditjen e përcaktuar nga komisioni i vlerësimit. Në urdhër përcaktohet edhe funksioni që do të kryejë punonjësi.
8. Procedurat e detajuara për fitimin e gradës nga momenti i shpalljes së procesit të konkurrimit deri në përfundim të procesit të ankimit përcaktohen në rregulloren e Policisë.

Neni 89

Ankimi

1. Punonjësi i policisë ka të drejtën e ankimit në komisionin e apelimit në çdo fazë të procesit për fitimin e gradës. Ushtrimi i së drejtës së ankimit brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e Policisë pezullon nxjerrjen e urdhrit të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe efektet e aktit të vlerësimit të komisionit të vlerësimit që është ankimuar.
2. Komisioni i apelimit kryesohet nga zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit dhe afatet e ankimit përcaktohen në rregulloren e Policisë.
3. Vendimi i komisionit të apelimit është i zbatueshëm menjëherë.

KREU IX

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PUNONJËSVE TË POLICISË

Neni 90

Atributet e Policisë Gjyqësore

Çdo punonjës i policisë gëzon atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me legjislacionin procedural penal dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Neni 91

Detyrime të përgjithshme të punonjësit të policisë

Punonjësi i policisë gjatë ushtrimit të kompetencave policore:

- a) është i detyruar të veprojë me profesionalizëm, paanshmëri, duke respektuar dinjitetin, integritetin, të drejtat dhe liritë e çdo individ, në përputhje me parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit;
- b) është i detyruar të respektojë Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- c) mban përgjegjësi individuale për ligjshmërinë e çdo veprimi ose mosveprimi gjatë kryerjes së detyrës;

- c) kur i kërkohet, ka detyrimin të qëndrojë në shërbim ose në gatishmëri, në përputhje me rregullat e miratuara me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- d) përmirëson aftësitë profesionale dhe fizike nëpërmjet formimit profesional;
- dh) respekton dinjitetin dhe integritetin e çdo punonjësi tjetër të policisë;
- e) mirëadministron pronën publike, që i është besuar për ushtrimin e funksioneve të tij dhe ta përdorë atë vetëm për qëllime të përcaktuara nga ligji ose nga rregullorja e Policisë;
- ë) përdor me efektivitet kohën e tij të punës vetëm për kryerjen e detyrave që lidhen me ushtrimin e funksionit;
- f) nuk krijon kontakte të papërshtatshme dhe merr çdo masë për të qenë jashtë çdo ndikimi prej tyre;
- g) me veprimet dhe mosveprimet e tij ndikon në ruajtjen dhe forcimin e besimit të Policia e Shtetit, duke ruajtur dinjitetin e funksionit;
- gj) merr masat për të parandaluar arratisjen e një personi në rastet e ndalimit të përkohshëm policor, të arrestimit e të zbatimit të urdhrit të ndalimit dhe masave të sigurimit personal;
- h) kërkon ndihmë mjekësore dhe merr masat realisht të zbatueshme për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e personit, që ka në ruajtje ose që e ka dëmtuar atë gjatë kryerjes së një veprimi kur është në detyrë;
- i) i vjen në ndihmë një punonjësi tjetër të policisë gjatë ushtrimit të detyrës, kur vlerëson se ai ka nevojë për ndihmë, me përjashtim të rasteve kur kjo ndihmë refuzohet, por duke vlerësuar e zbatuar në çdo rast përparësinë në kryerjen e detyrës;
- j) përdor uniformën, shenjat dhe simbolet e policisë vetëm gjatë kryerjes së shërbimit dhe në përputhje me rregullat e vendosura. Në përputhje me urdhrin e marrë nga eprori i tij, punonjësi i policisë mund t'i kryejë detyrat policore pa e veshur uniformën;
- k) është i detyruar që përpunimin e të dhënave personale gjatë veprimtarisë së tij ta kryejë me mjete të sigurta dhe të autorizuar.

Neni 92

Detyrimi për të zbatuar urdhrin

1. Punonjësi i policisë ka detyrimin të zbatojë të gjithë urdhrat e ligjshëm që jepen nga një punonjës më i lartë në funksion ose në gradë.
2. Punonjësi i policisë, nëse ka arsye të dyshojë se urdhri i dhënë është i paligjshëm, ai menjëherë ia bën të ditur eprorit dhe, kur është e mundur, kërkon me shkrim që urdhri të jepet me shkrim. Në çdo rast, kur ka kërkesë për dhënien e urdhrit me shkrim, eprori është i detyruar të japë urdhrin me shkrim.
3. Në rastet kur moszbatimi i urdhrit deri në dhënien e tij me shkrim, sipas pikës 2 të këtij neni, rrezikon jetën e një personi tjetër, punonjësi i policisë duhet të zbatojë urdhrin.
4. Kur një punonjës policie, edhe pas zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë nen, vazhdon të ketë arsye për të dyshuar se urdhri është i paligjshëm, ai kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) kundërshton urdhrin, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni;
 - b) vë menjëherë në dijeni punonjësin e policisë, i cili është drejtpërdrejt në një funksion më të lartë sesa eprori që ka dhënë urdhrin, si dhe për masat e marra prej tij në zbatim të këtij neni.
5. Procedurat e detajuara të dhënies, transmetimit, të kundërshtimit të zbatimit të një urdhri, që konsiderohet i paligjshëm, përcaktohen në rregulloren e Policisë.
6. Të njëjtat procedura do të zbatohen për urdhrat ose udhëzimet e eprorëve që bien ndesh me rregullat e etikës.

Neni 93

Detyrimi për të raportuar paligjshmërinë

1. Punonjësi i policisë ka detyrimin:

a) t'i raportojë eprorit përkatës ose, në mungesë të tij, eprorit të eprorit çdo ankesë të marrë në lidhje me sjelljen e një punonjësi tjetër të policisë dhe çdo shkelje për të cilën ai ka dyshime të mjaftueshme të besojë se është kryer, pavarësisht nëse ai ka marrë dijeni për këtë shkelje gjatë kryerjes së detyrës ose në rrethana të tjera;

b) t'i raportojë eprorit përkatës ose, në mungesë të tij, eprorit të eprorit çdo shkelje për të cilën ai ka dyshime të mjaftueshme të besojë se është kryer nga një person, pavarësisht nëse ai ka marrë dijeni për këtë shkelje gjatë kryerjes së detyrës ose në rrethana të tjera.

2. Veprimet ose vendimet me natyrë hakmarrëse ndaj punonjësit të policisë, që sinjalizojnë një veprim ose praktikë të dyshuar të paligjshme ose kundërshton një urdhër të dyshuar si të paligjshëm, trajtohen sipas procedurave të përcaktuara të legjislacionit në fuqi për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi, të këtij ligji dhe të rregullores së Policisë së Shtetit.

3. Në çdo rast, kur vërtetohen, pasojat e ardhura nga këto vendime apo veprime janë të pavlefshme.

Neni 94

Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit

1. Punonjësi i policisë nuk duhet të përdorë informacionin e mbledhur gjatë ushtrimit të detyrës për qëllime të tjera jashtë atyre të përcaktuara me ligj.

2. Punonjësi i policisë ka detyrimin të sigurojë mbrojtjen dhe mospërhapjen e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, me të cilat njihet gjatë ushtrimit të detyrës. Ky detyrim zbatohet edhe nga punonjësi i policisë i liruar ose i përjashtuar.

Neni 95

Informimi i publikut

1. Policia e Shtetit dhe strukturat e saj me përgjegjësi në transmetimin e informacionit informojnë publikun dhe medien për veprimtarinë e ushtruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, veçanërisht ligjin që garanton aksesin e qytetarëve në informacione publike.

2. Policia e Shtetit dhe strukturat e saj me përgjegjësi në transmetimin e informacionit nuk duhet të komunikojnë publikisht në mënyrë joetike, duke cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e mosdiskriminimit dhe dinjitetin e personit të dyshuar, të viktimave të krimit dhe të të miturve.

3. Imazhet dhe fotografitë e të miturve nuk duhet të bëhen publike.

4. Imazhet dhe fotografitë e personave nuk duhet të publikohen, përveç rasteve kur janë autorë të veprave penale apo të shpallur në kërkim.

Neni 96

Pjesëmarrja në veprimtari politike, greva dhe sindikata

1. Punonjësit të policisë i ndalohet:

a) të jetë anëtar i një partie ose organizate politike;

b) të mbështesë fushatën e një partie, organizate politike, të një anëtar i një partie politike apo të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë ose duke kontribuar fizikisht ose financiarisht. Punonjësit të policisë i ndalohet të marrë pjesë me uniformë, edhe nëse nuk është në shërbim, në mbledhje dhe në tubime të partive, të shoqatave dhe të organizatave politike ose sindikaliste, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

2. Punonjësi i policisë nuk ka të drejtë që të kandidojë dhe as të zgjidhet pa hequr dorë nga detyra në funksione politike. Punonjësi i policisë nuk ka të drejtë që të kryejë çdo veprimtari politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim me ndonjë parti politike ose jo, të krijojë ndonjë

konflikt interesi ose, në çdo rast, që mund të krijojë përshtypjen që punonjësi i policisë është i paanshëm dhe i pandikuar.

3. Punonjësit e policisë kanë të drejtë të organizohen në sindikata për të mbrojtur interesat e tyre profesionalë dhe të drejtat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Sindikatat e punonjësve të Policisë së Shtetit formohen, drejtohen dhe përfaqësohen nga pjesëtarë të Policisë së Shtetit, në shërbim aktiv ose në pension dhe mbrojnë interesat e tyre. Ata nuk mund të anëtarësohen apo të kenë marrëdhënie organizative me shoqata të tjera sindikale.

5. Veprimtaria e sindikatës ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për sindikatat. Marrëdhëniet e sindikatës me punonjësit e policisë rregullohet në bazë të akteve për themelimin, organizimin dhe funksionimin e sindikatës.

6. Drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit i ndalohet anëtarësimi në sindikata gjatë kohës së ushtrimit të detyrës. Marrëdhëniet ndërmjet sindikatave dhe punonjësve të policisë rregullohen në kontratën kolektive.

7. Punonjësit të policisë i ndalohet të mbajë armë ose të përdorë mjete dhe pajisje policore në aktivitete që lidhen me sindikatat.

8. Punonjësit të policisë i ndalohet të marrë pjesë në greva, protesta ose manifestime të çdo lloji.

Neni 97

Konflikti i interesit

1. Punonjësi i policisë mund të punësohet ose të kryejë veprimtari të tjera private vetëm në rastet kur kjo veprimtari nuk cenon dhe nuk bie ndesh me përgjegjësitë e lidhura me funksionin ose nuk cenon performancën në punë dhe prezencën fizike në vendin e punës.

2. Në çdo rast, punonjësi i policisë ka detyrimin të marrë miratimin me shkrim të drejtuesit të strukturës për ushtrimin e veprimtarive të tjera private. Procedura e miratimit dhe lloji i veprimtarive të tjera private përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

3. Punonjësi i policisë duhet të informojë pa vonesë eprorin e tij të drejtpërdrejtë ose, në mungesë, eprorin e eprorit, në rastet e konfliktit real, të mundshëm ose të dukshëm të interesit dhe të zbatojnë udhëzimet e tij për të zgjidhur konfliktin.

4. Punonjësit të policisë për një periudhë njëvjeçare, pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, i ndalohet të punojë ose të ofrojë shërbime në shoqëri tregtare, organizata jofitimprurëse, shoqata ose çdo sipërmarrje tjetër, të cilat kanë qenë nën mbikëqyrjen e tij ose që kanë marrë pjesë në komisionet ose në bordet për licencimin apo dhënien e lejeve për ushtrimin e aktiviteteve të tyre gjatë shërbimit policor.

5. Punonjësi i policisë nuk duhet të përfaqësojë asnjë person ose organizatë në një mosmarrëveshje ose në marrëdhënie tregtare me Policinë e Shtetit për një periudhë dyvjeçare pas largimit nga detyra, kur përfaqësimi lidhet me detyrat që ai ka kryer gjatë kohës që ka qenë punonjës policie.

6. Në rast punësimi përpara periudhës njëvjeçare, ish-punonjësi i policisë duhet të informojë strukturën përkatëse në Policinë e Shtetit të paktën dy javë përpara fillimit të pozicionit të ri të punës.

7. Për punonjësin e policisë, krahas përcaktimeve të këtij neni, zbatohet legjislacioni në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në të njëjtën mënyrë si edhe për punonjësit e tjerë të administratës publike.

Neni 98

Rregullat për detyrimet dhe kufizimet

Rregullat për zbatimin e detyrimeve dhe të kufizimeve për të cilat nuk ka një rregullim të posaçëm nga legjislacioni në fuqi, miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, sipas kontratës kolektive të punës.

KREU X

MARRËDHËNIET, KUSHTET E PUNËS DHE TRAJTIMI I VEÇANTË I PUNONJËSIT

TË POLICISË

Neni 99

Statusi i punonjësit të policisë

Punonjësi i policisë ka status të veçantë të përcaktuar sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 100

Koha e punës dhe e pushimit

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Koha e punës dhe e pushimit për punonjësit e policisë, si rregull, është e njëjtë me atë të punonjësve të tjerë të administratës shtetërore.
2. Punonjësi i policisë gëzon të drejtën e pushimit vjetor, si dhe të pushimeve të tjera të pagueshme.
3. Pushimi vjetor për punonjësit e policisë është 28 deri në 40 ditë pune dhe jepet në mënyrë të shkallëzuar sipas vjetërsisë dhe gradave të përcaktuara në rregulloren e Policisë së Shtetit.
4. Kur për arsye pune e shërbimi, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se në muajin mars të vitit pasardhës, në të kundërt, kompensohet në vlerë financiare.
5. Punonjësi i policisë trajtohet me pushim ose pagë shtesë mbi kohën normale të punës.
6. Punonjësi i policisë mund të kryejë orë shtesë të punës në rastet e aktiviteteve artistike, sportive, infrastrukturore, zhvillimit urbanistik, monitorimit sezonal, në rastet e forcës madhore ose në çdo rast tjetër të punëve urgjente në dobi të popullsisë.
7. Rregullat e detajuara për kohën e punës dhe të pushimit, si dhe të trajtimit financiar të punonjësit të policisë, kur nuk kryen pushimet, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 101

Leja pa të drejtë page

1. Punonjësi i policisë gëzon të drejtën e lejes, pa të drejtë page, për një periudhë afatshkurtër deri në 2 muaj ose afatgjatë deri në 6 muaj, për arsye personale.
2. Leja afatshkurtër miratohet nga drejtuesi i strukturës dhe pas përfundimit të lejes punonjësi kthehet në të njëjtën detyrë.
3. Leja afatgjatë jepet për studime, kualifikime ose arsye personale të argumentuar dhe miratohet nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
4. Pas përfundimit të lejes afatgjatë, punonjësi ka të drejtë të kthehet në funksionin që kishte ose në funksion tjetër sipas gradës që mban.
5. Rregullat dhe procedurat për marrjen e lejes, pa të drejtë page, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 102

Kujdesi për punonjëset e policisë shtatzëna

1. Punonjëset e policisë shtatzëna ose me fëmijë në gji nuk mund të emërohen në funksione ose të kryejnë detyra apo shërbime që mund të dëmtojnë shëndetin e tyre dhe të fëmijës.
2. Nuk mund të urdhërohet kryerja e punës natën për punonjëset e policisë shtatzëna dhe ato që kanë lindur fëmijë deri kur fëmija të arrijë moshën 1 vjeç.
3. Kur punonjësja e policisë, për shkak të shtatzënisë ose fëmijës në gji, sipas pikës 2 të këtij neni, nuk mund të punojë natën, transferohet përkohësisht në një funksion të ngjashëm, me të njëjtën gradë, në të cilën detyrat mund të përmbushen gjatë ditës.
4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, cakton sektorët e shërbimeve policore, që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe të fëmijës, si dhe rregullat e veçanta për kushtet e punës në rastet kur

lejohet puna e natës për punonjësen e policisë shtatzënë, që ka lindur fëmijë deri kur fëmija të arrijë moshën 1 vjeç, si dhe punonjësen e policisë me fëmijë në gji.

Neni 103 **Leja e lindjes**

1. Punonjëset e policisë shtatzëna gëzojnë të drejtën e lejes së paralindjes dhe paslindjes, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Trajtimi financiar i punonjëseve të policisë, në rast leje lindjeje, përcaktohen nga ligji për sigurimet shoqërore.

Neni 104 **Trajtimi financiar gjatë qëndrimit në punë**

1. Paga e punonjësit të policisë dhe përfitimet e tjera financiare duhet të jetë në përputhje me dinjitetin, përgjegjësinë, shkallën e rrezikshmërisë së detyrës që kryen për të garantuar integritet në ushtrimin e funksioneve të tij.

2. Trajtimi financiar i punonjësit të policisë përbëhet nga:

a) paga mujore, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesa për funksion për punonjësit e rolit zbatues, shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 1% të nivelit më të ulët të gradës sipas ndarjes në role;

b) kompensimi për kufizimet që i krijohen punonjësit të policisë për largësinë nga vendbanimi, sipas koston të transportit publik dhe paga për papunësinë e bashkëshortit, të shkaktuar nga largësia e vendbanimit;

c) trajtimi me ushqim për punonjësit e policisë;

ç) ndihma financiare, në masën e një page mujore në rastet e fatkeqësive në familje, të përcaktuara në rregulloren e Policisë së Shtetit;

d) shpërblimi nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit deri në masën e 3 pagave mujore për rezultate të larta në kryerjen e detyrës. Shpërblimi përballohet nga fondi i pagave të Policisë së Shtetit;

dh) kompensim i menjëhershëm financiar në rast të dëmtimit të rëndë të pronës, për shkak të detyrës, sipas akteve të vlerësimit të dëmit;

e) kompensim financiar në masën e 3 pagave mujore në rast sëmundje të rëndë, vërtetuar me dokumentacion shoqëruar, të nxjerrë nga organet përgjegjëse shëndetësore;

ë) kompensim financiar i vazhdueshëm në masën e 1 page mujore në rast sëmundjeje të rëndë dhe që zgjat në kohë, vërtetuar me dokumentacion shoqëruar të nxjerrë nga organet kompetente shëndetësore;

3. Paga e punonjësit të policisë indeksohet sipas parashikimeve të ligjit në fuqi për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi.

4. Kriteret dhe procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të policisë, sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë” të pikës 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 105 **E drejta për sigurim shëndetësor të veçantë**

1. Punonjësit e strukturave të veçanta të Policisë së Shtetit, në funksion të përmbushjes së detyrës së tyre, përfitojnë sigurim shëndetësor të veçantë për shërbime shëndetësore, të cilat nuk janë pjesë e paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

2. Sigurimi i shëndetit për punonjësit e strukturave të veçanta të Policisë së Shtetit bëhet sipas kontratës së lidhur me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Ky sigurim mbulon shpenzimet për kontrollin parandalues, diagnostikues dhe kurues, të ofruara nga institucionet shëndetësore, brenda dhe jashtë vendit.

3. Strukturat e veçanta, lista e shërbimeve shëndetësore, autoriteti mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore, rast pas rasti, dhe procedurat për sigurimin shëndetësor të veçantë të punonjësve të policisë në këto struktura përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 106

E drejta për përfitim kredie të lehtësuar

Punonjësi i policisë përfiton kredi të lehtësuar për strehim sipas rregullave dhe kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi që rregullon kreditë e lehtësuara për blerjen e banesës për të punësuarit në administratën publike.

Neni 107

Kompensimi për strehim

1. Kur punonjësi i policisë emërohet ose transferohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, brenda dhe jashtë vendit, i paguhet qiraja e banesës, kur nuk i sigurohet ajo.

2. Kriteret dhe masa e përfitimit të pagesës së qirasë për strehim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 108

Kompensim në rastet e plagosjes dhe dëmtimit të shëndetit të punonjësve të policisë

1. Në rast të plagosjes ose dëmtimit të shëndetit, gjatë ose për shkak të detyrës, punonjësit e policisë përfitojnë kompensim, i cili mbulohet nga buxheti i Policisë së Shtetit.

2. Rregullat, procedurat dhe masa e kompensimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 109

Mbrojtja e veçantë

1. Policia siguron mbrojtje të veçantë për punonjësin e policisë, të cilit i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës.

2. Kushtet dhe mënyra e mbrojtjes së veçantë për punonjësin e policisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 110

Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës

1. Punonjësi i policisë, që ndërpret marrëdhëniet e punës me Policinë e Shtetit, përfiton:

- a) pagesë kalimtare;
- b) pension të parakohshëm suplementar;
- c) pension suplementar pleqërie.

2. Trajtimi financiar sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni bëhet sipas parashikimeve të ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë

së Burgjeve, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Punonjësi i policisë, pas daljes në pension pleqërie, përfiton shpërblim në masën e 3 (tre) pagave mujore, sipas pagës bruto të muajit të fundit, i cili paguhet nga buxheti i Policisë së Shtetit.

Neni 111

Trajtimi i familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës

1. Kur punonjësi i policisë humb jetën për shkak të detyrës, pjesëtarët e familjes përfitojnë:

a) ndihmë të menjëhershme financiare deri në 10 paga mujore, sipas pagës referuese të muajit të fundit;

b) pension familjar suplementar në masën 100 % të pagës mujore të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periudha e sigurimit. Përfitimet jepen në vlerën 100 % të pagës, sa herë që paga, sipas së cilës është llogaritur ky përfitim, ndryshon;

c) rimbursim në masën 100 % të bursës së studimit në institucionet e arsimit publik për fëmijët e punonjësit;

ç) banesë falas për bashkëshorten/in dhe fëmijët kur janë të pastrehë, sipas procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;

d) ndihmë financiare në masën e 1 page mujore, sipas pagës referuese, çdo përvjetor vdekjeje;

dh) organizimin e ceremonisë mortore nga drejtuesi i strukturës dhe shpenzimet paguhet nga buxheti i Policisë;

e) punësim me prioritet në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kritere të tjera të nevojshme për vendin e punës.

2. Rregullat dhe procedurat e trajtimit të familjarëve të punonjësve, që humbin jetën për shkak të detyrës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 112

E drejta për mbështetje psikologjike

1. Punonjësit të policisë i ofrohet ndihmë dhe mbështetje psikologjike, në rast të përjetimit të stresit dhe gjendjes së rënduar psikologjike gjatë kryerjes së detyrave policore ose pas ngjarjeve të ndodhura, me pasoja në shëndetin mendor të tij.

2. Në rastin kur konstatohet çrregullim i përkohshëm i shëndetit mendor të punonjësit të policisë, eprori merr masa për tërheqjen e armatimit personal deri në një vlerësim të specializuar të shëndetit mendor të punonjësit.

3. Procedurat e trajtimit të rasteve të punonjësve të policisë, që kanë nevojë për mbështetje psikologjike, përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale.

KREU XI

TRANSFERIMI

Neni 113

Transferimi i punonjësit të policisë

1. Punonjësi i policisë transferohet nga një detyrë në një tjetër brenda së njëjtës gradë që mban, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren e Policisë.

2. Punonjësi i policisë gjatë periudhës 1-vjeçare të provës nuk transferohet, me përjashtim të rasteve të mbylljes apo ristrukturimit të njësisë, ku punonjësi bën pjesë.

3. Drejtorët e drejtorive vendore të policisë apo titullarët e strukturave të veçanta transferojnë punonjës policie të rolit zbatues dhe të rolit të parë drejtues me gradën “nënkomisar” në funksione, të cilat janë brenda juridiksionit të tyre.

4. Transferimi punonjësve të policisë me gradë “drejtues i lartë” ose në funksione që i korresponduan grada “drejtues i lartë” bëhet me urdhër të ministrit, pas propozimit të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

5. Punonjësi i policisë nuk mund të transferohet pa përfunduar afatin minimal prej 2 vjetësh të qëndrimit në detyrë, me përjashtim të rasteve të veçanta të miratuara nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

6. Në çdo rast, transferimi i punonjësit të Policisë së Shtetit bëhet me vendim të motivuar dhe i komunikohet personit të transferuar.

7. Rregullat dhe procedurat e transferimit përcaktohen në rregulloren e Policisë.

Neni 114

Transferimi i përkohshëm i punonjësit të policisë

1. Punonjësi i policisë transferohet përkohësisht në një detyrë tjetër për përballimin e dinamikës së punës, si rezultat i situatave të paparashikuara.

2. Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj.

3. Rregullat dhe procedurat e transferimit të përkohshëm përcaktohen në rregulloren e Policisë.

Neni 115

Transferimi i punonjësit të policisë në struktura të tjera shtetërore

1. Transferim në struktura të tjera shtetërore është emërimi i punonjësit të policisë në një institucion publik jashtë Policisë së Shtetit.

2. Punonjësi i policisë mund të transferohet në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, në institucionet e sistemit të drejtësisë, në institucione të tjera të administratës shtetërore, të cilat për nga fusha e veprimtarisë janë të ngjashme me Policinë e Shtetit, si dhe në organizata ndërkombëtare, të cilat nuk përfshihen në rastet e parashikuara në nenin 130 të këtij ligji.

3. Punonjësi i policisë mund të transferohet në funksione të ndryshme në struktura të tjera shtetërore vetëm me pëlqimin e tyre. Nuk lejohet transferimi i një punonjësi policie që ushtron një detyrë me mandat të kufizuar.

4. Punonjësi i policisë, i transferuar në një strukturë tjetër shtetërore, ka të njëjta të drejta dhe detyrime si edhe çdo punonjës tjetër policie, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

5. Periudha e transferimit të punonjësit të policisë nuk mund të jetë më shumë se 5 (pesë) vjet, me përjashtim të rasteve kur legjislacioni në fuqi parashikon ndryshe. Punonjësi i policisë duhet të shërbejë në strukturat e policisë jo më pak se 5 vjet, pas periudhës së transferimit. Pas përfundimit të kësaj periudhe, punonjësi i policisë ka të drejtë të transferohet në struktura të tjera shtetërore edhe për 5 vjet të tjera.

6. Punonjësi i policisë, që transferohet në një organizatë ndërkombëtare, me qëllim përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në atë organizatë, gëzon të njëjtin status me diplomatët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë.

7. Gjatë kohës që punonjësi i policisë shërben si i transferuar në pozicione të ndryshme jashtë strukturës së Policisë së Shtetit, ai nuk gëzon atributet që lidhen me statusin e Policisë Gjyqësore, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm i njeh atributet e Policisë Gjyqësore ose kur për shkak të transferimit duhet t'i gëzojë edhe atributet e Policisë Gjyqësore.

8. Punonjësit të policisë së transferuar i bëhet vlerësimi i performancës, në përputhje me kriteret dhe procedurën që zbatohet për punonjësit e tjerë të atij institucioni, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.

9. Punonjësi i policisë i transferuar ka përgjegjësi disiplinore, në përputhje me kriteret dhe procedurën që zbatohet për punonjësit e tjerë të atij institucioni. Në rastet kur institucioni, në të cilin punonjësi i policisë që është transferuar propozon përjashtimin nga policia, si masë disiplinore, shqyrtimi i propozimit kryhet në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

10. Në rastet kur punonjësi i policisë transferohet në administratën publike, ai emërohet në funksione me nivel ekuivalent me gradën e tij policore.

11. Punonjësi i policisë, i transferuar sipas këtij neni, rikthehet në detyrë brenda strukturave të Policisë së Shtetit sipas të njëjtave rregulla dhe procedura që ndiqen edhe në rastin e transferimit të tij brenda strukturave të saj, në përputhje me kualifikimin profesional dhe gradën policore.

12. Periudha e shërbimit të punonjësit të Policisë së Shtetit, të transferuar sipas këtij neni në funksione jashtë Policisë së Shtetit, konsiderohet si periudhë e vlefshme për efekte të vjetërsisë së shërbimit.

13. Trajtimi financiar i punonjësve të policisë, që transferohen në funksione shtetërore, bëhet sipas kategorisë së pagës që i korrespondon funksionit ku punonjësi i policisë është transferuar, por në çdo rast nuk mund të jetë më i ulët se sa paga për gradën që mban në momentin e transferimit.

14. Rregullat dhe procedura për transferimin e punonjësve në institucione të tjera shtetërore, përfundimi përpara kohe i periudhës së transferimit, ekuivalentimi i gradave të Policisë së Shtetit me kategoritë e funksioneve të administratës shtetërore për transferimin në institucionet e tjera të administratës shtetërore përcaktohen në rregulloren e Policisë.

KREU XII NDËRPRERJA E MARRËDHËNIEVE TË PUNËS

Neni 116

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës të punonjësit të policisë

1. Punonjësi i policisë ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet nga Policia.
2. Punonjësi i policisë lirohet nga Policia në rastet kur:
 - a) mbush moshën për pension pleqërie;
 - b) deklarohej i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) shkurtohet funksioni në kuadër të pakësimit të numrit të përgjithshëm organik të Policisë dhe nuk ka funksione të lira sipas gradës përkatëse, sipas rregullave të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni;
 - d) konstatohet pavlefshmëria e aktit të pranimi;
 - dh) vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për shpalljen e zhdukjes ose të vdekjes së tij;
 - e) humbet shtetësinë shqiptare;
 - ë) merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
 - f) nuk pajiset me Certifikatën e Sigurisë së Personelit pas dy aplikimeve të njëpasnjëshme;
 - g) pas dy vlerësimeve periodike vjetore të njëpasnjëshme “jomjaftueshëm” të rezultateve në punë;
 - gj) nuk kalon programin e formimit të detyrueshëm në shërbim, edhe pas përsëritjes së tij;
 - h) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit, të deklaruar nga vetë punonjësi dhe, sipas ligjit, nuk merr masat e parashikuara për shmangien e konfliktit të interesit brenda afatit të përcaktuar, apo nëse transferimi në një pozicion tjetër nuk do të mënjanonte gjendjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesit.
3. Punonjësit të policisë, të cilit i shkurtohet funksioni organik si pasojë e pakësimit të numrit të përgjithshëm organik të policisë, i ruhet grada që mban deri në 1 vit dhe nëse nuk ka një vend të lirë për gradën që mban, i ofrohet një funksion që korrespondon me gradën tjetër më të ulët me gradën që mban. Pas përfundimit të afatit 1-vjeçar, kur nuk janë krijuar pozicione të reja për gradën që mban, fiton gradën e funksionit që ushtron.
4. Në pamundësi sistemimi për gradën që mban dhe kur punonjësi nuk pranon të ulet në gradë, sipas pikës 3, punonjësi lirohet nga Policia.
5. Punonjësi i policisë pezullohet nga Policia në rastet kur:
 - a) ndaj tij ka nisur një procedim penal për një krim të kryer me dashje dhe është dhënë masa e sigurisë “arrest me burg” dhe “arrest në shtëpi”;

- b) kur merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje.
6. Punonjësi i policisë përjashtohet nga Policia në rastet kur:
- a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b) merret masa disiplinore e përjashtimit nga Policia;
 - c) deklaron të dhëna të rreme në formularët e vetëdeklarimit, për qëllime të veprimtarisë policore.
7. Punonjësi i policisë, i cili ndërpret marrëdhëniet e punës, në rastet e shkronjave “ç” dhe “d” të pikës 2 të këtij neni, dhe kur ndaj tij është marrë masa disiplinore e përjashtimit nga Policia, ai ka të drejtë të ankohet në komisionin e apelimit ose drejtpërdrejt në gjykatë.
8. Rregullat dhe procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës përcaktohen në rregulloren e Policisë.

Neni 117

Rikthimi në Policinë e Shtetit

(Ndryshuar pika 2 dhe shfuqizuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Një person rikthehet në Polici kur nuk ekziston më pengesa ligjore, e përcaktuar në shkronjat “b” deri në “ë” të pikës 2 të nenit 116, për lirimin e tij.
2. Rikthimi në Policinë e Shtetit bëhet kur ka vende të lira në funksionin dhe gradën korresponduese që punonjësi ka pasur në kohën e lirit.
3. Shfuqizuar.
4. Shfuqizuar.

Neni 118

Pranimi, transferimi dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës për funksionet civile në Policinë e Shtetit

1. Pranimi, transferimi dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës së nëpunësve civilë bëhet bazuar në legjislacionin për nëpunësin civil.
2. Pranimi, transferimi dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës për punonjësit administrativë bëhet me urdhër të titullarit të strukturës qendrore ose vendore, sipas Kodit të Punës.

KREU XIII DISIPLINA

Neni 119

Sjellja dhe etika

1. Punonjësi i policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe të etikës gjatë përmbushjes së detyrave.
2. Normat dhe rregullat e sjelljes dhe të etikës përcaktohen në rregulloren e Policisë.

Neni 120

Shkeljet disiplinore

1. Çdo veprim ose mosveprim i punonjësit të policisë, që bie në kundërshtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj, në Rregulloren e Policisë dhe në ligje të tjera në fuqi, që përcaktojnë detyrime për Policinë e Shtetit, kur nuk përbën vepër penale, është shkelje disiplinore.
2. Punonjësi i policisë kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur:
 - a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e Policisë së Shtetit ose dëmtojnë besimin e publikut;

b) gjatë ushtrimit të funksionit nuk i referohet ligjit ose fakteve, me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale.

Neni 121

Llojet e shkeljeve disiplinore

1. Llojet e shkeljeve në lidhje me ushtrimin e funksionit janë:

a) mospërbushja e detyrave ose mosrespektimi i përsëritur i afateve në përbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda;

b) nxjerrja e paaftëzuar e informacionit policor;

c) shkelja e rregullave të konfidencialitetit për ruajtjen e informacionit të klasifikuar dhe atij policor apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla;

ç) veprimet komprometuese;

d) keqpërdorimi i atributave dhe kompetencave të policisë, që sjellin pasoja të rënda;

dh) përdorimi i paligjshëm i armës;

e) përdorimi i paligjshëm dhe i paarsyeshëm i forcës;

ë) dëmtimi i rëndë, shpërdorimi ose humbja e pronës së policisë;

f) përdorimi i pijeve alkoolike gjatë punës/shërbimit dhe jashtë saj, kur është me uniformë;

g) përdorimi i lëndëve narkotike;

gj) ngacmimet seksuale;

h) veprimet diskriminuese në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër, kur këto veprime kryhen për më shumë se një shkak, më shumë se një herë, veprimi ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore ose ka sjellë pasoja të rënda për viktimën;

i) moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale;

j) braktisja e detyrës dhe mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për një periudhë prej 7 ditësh pune ose më shumë;

k) përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat merren për shkak të detyrës;

l) shkelja e përsëritur e rregullave të etikës;

ll) sjellja e parregullt, në mënyrë të përsëritur, gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun;

m) kryerja e veprimeve që cenojnë rëndë figurën e punonjësit të policisë, institucionin apo shërbimin policor në tërësi;

n) ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e funksionit të një punonjësi tjetër policie apo të çdo funksioni tjetër shtetëror;

nj) veprimi, mosveprimi ose sjellja e punonjësit të policisë, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët e treta, në kundërshtim me ligjin;

o) shkelja e detyrimeve të tjera, të përcaktuara në këtë ligj.

2. Llojet e shkeljeve jashtë ushtrimit të funksionit janë:

a) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë me funksionin ose të kufizimeve për shkak të funksionit;

b) përdorimi i statusit të punonjësit të policisë, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët;

c) ushtrimi i veprimtarive me pagesë, jashtë funksionit, pa miratim paraprak me shkrim të eprorit;

ç) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale janë subjekt të një procedimi penal ose me persona të dënuar dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me punonjësin e policisë ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona;

d) përfitimi i padrejtë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të funksionit që ushtron punonjësi i policisë ose, si rrjedhojë e shfrytëzimit të pozicionit që ushtron, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik;

dh) raste të tjera të sjelljes që diskrediton imazhin dhe dëmton besimin e publikut të Policia e Shtetit, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.

Neni 122

Masat parandaluese për shkeljet disiplinore

1. Masa parandaluese ka synim mospërsëritjen ose përshkallëzimin e mangësive të konstatuara gjatë veprimtarisë së përditshme të punonjësit të policisë, pa përdorur procesin e ecurisë disiplinore.

2. Masat parandaluese janë:

a) “këshillim”;

b) “tërheqje vëmendjeje”.

Neni 123

Masat disiplinore

Masat disiplinore, që zbatohen ndaj punonjësit të policisë, janë si më poshtë:

a) vërejtje;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) ulje e përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë se 1 vit;

ç) shtyrje e afatit të gradimit deri në 5 vjet;

d) ulje me një gradë për një periudhë deri në 5 vjet;

dh) pezullim nga detyra për një periudhë nga 3 muaj deri në 2 vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;

e) përjashtim nga Policia.

2. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, eprori direkt ose komisioni disiplinor bazohet në:

a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;

b) shkallën e fajësisë;

c) ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashuara;

ç) shpeshtësinë e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes;

d) çdo veprim që punonjësi ka ndërmarrë për të zbutur dëmin e pësuar nga subjektet;

dh) shkallën e bashkëpunimit me strukturat përkatëse (organi që heton dhe jep masën disiplinore) për konstatimin dhe ndreqjen e shkeljes së kryer dhe zbutjen e efekteve të mundshme negative të saj;

e) përvojën dhe pozicionin e punonjësit në Policinë e Shtetit;

ë) mënyrën në të cilën shkelja është sjellë në vëmendje të strukturat përkatëse (organi që heton dhe jep masën disiplinore), veçanërisht nëse punonjësi ka njoftuar vetë për shkeljen dhe, nëse po, deri në çfarë mase e ka bërë këtë;

f) çdo situatë që është jashtë kontrollit të punonjësit.

3. Afati për shuarjen e masave disiplinore, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, është:

a) 6 muaj për masën disiplinore “vërejtje”;

b) 1 vit për masën disiplinore “vërejtje me paralajmërim”;

4. Afati për shuarjen e masave disiplinore, të përcaktuara në shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, është 2 vjet, i cili fillon të llogaritet nga data e përfundimit të afatit të masës disiplinore.

5. Masa disiplinore “përjashtim nga Policia e Shtetit” nuk parashkruhet.

6. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer dhe për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.

7. Procedura e shqyrtimit të shkeljeve dhe e shqyrtimit të ankimit për masën e dhënë për punonjësin e policisë përcaktohen në rregulloren e Policisë.

8. Efektet e masës disiplinore për punonjësin e policisë fillojnë kur vendimi për dhënien e masës ka marrë formë të prerë.

9. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 3 (tre) vjetëve. Afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer.

10. Punonjësi i policisë ndaj të cilit merret masa disiplinore “vërejtje” ose “vërejtje me paralajmërim” ka të drejtë të ankohet tek eprori i punonjësit që i ka dhënë masën brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes dijeni me shkrim për dhënien e masës disiplinore.

11. Punonjësi i policisë ndaj të cilit merren masat disiplinore, të përcaktuara në shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, ka të drejtë të ankohet në komisionin e apelimit brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes dijeni me shkrim për dhënien e masës disiplinore.

12. Përbërja dhe funksionimi i komisioneve për dhënien masave disiplinore dhe apelimin e tyre përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

13. Punonjësi i policisë ka të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë, sipas këtij neni, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 124

Masat disiplinore plotësuese

Masat disiplinore, në varësi të natyrës së shkeljes, dhe, kur është e nevojshme për korrigjimin e veprimit ose mosveprimit të punonjësit të policisë, shoqërohen me masa plotësuese, por pa u kufizuar në, si më poshtë:

- a) trajnim të detyrueshëm, sipas një programi të posaçëm të formimit të vazhduar;
- b) këshillim mjekësor ose psikologjik;
- c) ndalim të drejtimit të mjeteve të Policisë deri në 1 vit;
- ç) ndalimi të përdorimit të armës deri në aftësimin për përdorimin e saj me trajnimin përkatës.

Neni 125

Këshillat konfidenciale

1. Pranë strukturës përgjegjëse për burimet njerëzore në Policinë e Shtetit krijohen dhe funksionojnë këshillat konfidencialë të Policisë së Shtetit për të ofruar këshillim konfidencial për punonjësit e policisë për çështjet e etikës, integritetit, korrupsionit, konfliktit të interesit, konfidencialitetit dhe çështje të lidhura me to, udhëzime praktike dhe shpjegime konkrete në lidhje me legjislacionin në fuqi për këto aspekte, sjelljen e pritshme nga punonjësit e policisë, duke marrë parasysh specifikën, shumëllojshmërinë e detyrave dhe vështirësitë me të cilat përballen gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e policisë.

2. Këshillat konfidencialë të Policisë së Shtetit ofrojnë këshillim edhe për procedurat në fuqi për trajtimin e shkeljeve disiplinore dhe ankimimit të tyre.

3. Organizimi, funksionimi dhe përbërja e këshillave konfidencialë rregullohen me urdhër të ministrit.

KREU XIV

VLERËSIMI I PERFORMANCËS

Neni 126

Vlerësimi i performancës së punonjësit të policisë

1. Vlerësimi i punonjësit të policisë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të rezultateve në punë, bazuar në objektivat e përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive profesionale e fizike të punonjësit të policisë në kryerjen e detyrave.

2. Vlerësimi i rezultateve në punë të punonjësit të policisë bazohet në:

- a) realizimin e objektivave;

- b) sjelljen dhe kompetencat profesionale;
- c) komponentët e formimit të vazhduar në shërbim.

3. Komponentët e vlerësimit sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni, sipas roleve në Policinë e Shtetit, përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

4. Rastet e vlerësimit të rezultateve individuale në punë për punonjësit janë:

- a) vlerësimi periodik vjetor;
- b) në periudhë prove;
- c) për transferime në detyrë;
- ç) për fitimin e gradës;
- d) me kërkesën e vetë punonjësit.

5. Vlerësimi i punonjësit bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë dhe miratohet nga titullari i strukturës së Policisë, ku punonjësi është i emëruar.

6. Kriteret dhe procedurat për vlerësimin e rezultateve në punë për punonjësit e policisë përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.

Neni 127

Certifikata vlerësimi dhe medalje

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 90/2026, datë 23.7.2026)

1. Përveç dekoratave dhe titujve të nderit, që jepen nga autoritete të tjera, sipas legjislacionit në fuqi, për punonjësit e policisë jepen medalje për merita në kryerjen e detyrave dhe për vjetërsi në shërbim.

2. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit jep këto medalje:

a) për merita në kryerjen e detyrave:

- i. Medalje “Mirënjohje”;
- ii. Medalje “Për rezultate të larta”
- iii. Medalje “Për merita të veçanta”.

b) për vjetërsi në shërbim:

- i. Medalje bronzi e karrierës 15-vjeçare;
- ii. Medalje argjendi e karrierës 20-vjeçare;
- iii. Medalje ari e karrierës 30-vjeçare.

3. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit jep edhe certifikata për personelin e policisë.

4. Drejtuesit e departamenteve të Policisë së Shtetit japin certifikata të karrierës për punonjësit e policisë në varësi të tyre.

5. Drejtorët e drejtorive vendore të Policisë së Shtetit dhe drejtuesit e strukturave të veçanta japin certifikata për shërbime të dalluara për punonjësit e policisë në varësi të tyre.

6. Motivi, rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e medaljeve e certifikatave dhe shpërblimi përkatës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU XV

BASHKËPUNIMI I POLICISË

Neni 128

Bashkëpunimi me komunitetin, shoqërinë civile dhe institucionet shtetërore

1. Për përmbushjen e misionit të saj, si një polici e orientuar drejt shërbimit për komunitetin, Policia e Shtetit duhet:

a) të ndihmojë dhe të mbështesë grupet e cënueshme dhe të marginalizuara, duke u kushtuar vëmendje të veçantë viktimave të krimit, dhunës në familje, diskriminimit ose përjashtimit social;

b) të angazhohet në veprime policore proaktive dhe të orientuara drejt interesave të komunitetit për zgjidhjen e problematikave në fushën e rendit dhe sigurisë publike;

c) të rrisë transparencën dhe mekanizmat e llogaridhënies përmes raportimit dhe informimit të publikut, mbikëqyrjes dhe kontrollit të jashtëm.

2. Policia e Shtetit bashkëpunon me organizatat që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, bashkësitë fetare të njohura me ligj, organizatat jofitimprurëse dhe shoqatat për të krijuar partneritet për rendin dhe sigurinë publike.

3. Policia u siguron këtyre organizatave informacion në lidhje me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të ndaluar në ambientet e policisë, në bazë të dokumenteve zyrtare që zotëron.

4. Policia e Shtetit bashkëpunon me institucionet e sigurisë publike dhe administratës shtetërore, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, me përmbaruesit gjyqësorë, me personat fizikë e juridikë, me shoqërinë civile, me përfaqësuesit e komuniteteve fetare, me komunitetin, si edhe me organe apo subjekte të tjera, sipas përcaktimeve në legjislacionin e posaçëm në përmbushjen e funksioneve të saj.

5. Policia e Shtetit bashkëpunon me administratën zgjedhore dhe raporton veprimtarinë e strukturave të policisë për zbatimin e detyrave në shërbim të administrimit të qetë e të rregullt të proceseve zgjedhore ose të referendumeve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj, në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

6. Policia e Shtetit bashkëpunon dhe koordinon punën me inspektoratet kompetente në fushën e ndërtimit, kontrollit të mjedisit dhe territorit për marrjen e sanksioneve administrative dhe sanksioneve të tjera, sipas ligjit të tyre funksional.

7. Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, parandalimin e krimit dhe përballimin e situatave të emergjencave civile, Policia e Shtetit mbështetet nga policimi vullnetar. Organizimi, funksionimi dhe fusha e veprimit të policimit vullnetar rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 129

Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Strukturat e Policisë bashkëpunojnë me njësitë e vetëqeverisjes vendore për:

a) parandalimin e krimit, në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, duke respektuar autonominë vendore, si dhe për çështje që lidhen me mjedisin;

b) hartimin në nivel vendor të masave për policimin në komunitet, në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregulloren e Policisë;

c) planifikimin dhe koordinimin mes tyre të masave në fushën e rendit dhe sigurisë publike në strukturat vendore të Policisë, në zbatimin e planit vjetor të punës së strukturave të Policisë së Shtetit, dhe marrin masa për përmbushjen edhe të objektivave në fushën e sigurisë publike të qeverisjes vendore, ku ushtrojnë kompetencat e tyre territoriale;

ç) shkëmbimin e informacionit, problematikat dhe informimin për zbatimin e masave për rendin dhe sigurinë publike.

2. Masat e policimit në komunitet për parandalimin e krimit zhvillohen në nivel vendor, duke konsideruar natyrën dhe kërkesat e tyre të veçanta.

3. Drejtuesit vendorë të Policisë paraqesin një raportim vjetor tek organi i zgjedhur i njësisë vendore përkatëse për çështjet e rendit e të sigurisë publike, masat e marra dhe detyrat e përcaktuara për përmirësimin e saj.

Neni 130

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Policia bashkëpunon me agjencitë ligjzbatuese të shteteve apo organizatave, organeve apo institucioneve të tjera ndërkombëtare në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare apo ndërinsticionale.

2. Policia e Shtetit në veprimtarinë e saj bashkëpunon me policitë e vendeve të tjera, si dhe me organizata të tjera ndërkombëtare policore.

3. Policia e Shtetit shkëmben informacionin përkatës dhe lehtëson bashkëpunimin ndërkombëtar policor edhe në lidhje me ndeshjet e futbollit me dimension ndërkombëtar.

4. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike cakton punonjës policie në detyrë jashtë vendit në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare ose ndërinstytucionale:

a) si “oficerë ndërlidhës” pranë strukturave ligjzbatuese në një vend, organizatë ose një tjetër organ ndërkombëtar;

b) në një detyrë të përkohshme pranë strukturave të zbatimit të ligjit ose si pjesë e një misioni apo shërbimi në një organizatë ndërkombëtare për përmbushjen e detyrave policore.

5. Mandati i qëndrimit në detyrë të punonjësve të policisë, sipas shkronjave “a” dhe “b”, është deri në 5 vjet.

6. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit cakton dhe miraton pika kontakti në strukturat policore për lehtësimin e bashkëpunimit me njësi të zbatimit të ligjit, projekte, organizata apo organizma ndërkombëtarë policorë, në përmbushje të detyrimeve të marrëveshjeve të nënshkruara.

7. Oficerët ndërlidhës të Policisë së Shtetit caktohen për të kryer veprime të përbashkëta nga agjencitë ligjzbatuese vendase ose të huaja kur parashikohet në marrëveshje dhe siç është rënë dakord mes palëve.

8. Trajtimi financiar dhe ekonomik i punonjësve të Policisë së Shtetit, të caktuar në detyrë ose si oficerë ndërlidhës jashtë vendit, rregullohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë dhe me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Procedurat e përzgjedhjes, emërimit dhe akreditimit, fusha e veprimit, marrëdhëniet e varësisë dhe komunikimi, detyrat dhe përgjegjësitë e oficerëve ndërlidhës përcaktohen në rregulloren e oficerëve ndërlidhës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar, sipas rastit, edhe në përcaktimet e marrëveshjeve ndërkombëtare ose ndërinstytucionale.

10. Mënyra e komunikimit të strukturave të Policisë me partnerët ndërkombëtarë bëhet në bazë të marrëveshjeve përkatëse dhe sipas kriterëve të përcaktuar në udhëzimin e ministrit për ato çështje që nuk zgjidhen nga marrëveshja përkatëse.

KREU XVI MONITORIMI I BRENDSHËM DHE I JASHTËM I POLICISË

Neni 131

Monitorimi i veprimtarisë së Policisë së Shtetit

Veprimtaria e Policisë së Shtetit i nënshtrohet monitorimit të brendshëm dhe monitorimit të jashtëm.

Neni 132

Vlerësimi i performancës së strukturave të Policisë së Shtetit

1. Vlerësimi i performancës është vlerësimi i nivelit dhe cilësisë së përmbushjes së objektivave e detyrave nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit me efektivitet, eficiencë, në pajtueshmëri me legjislacionin dhe me standardet e përcaktuara në akte nënligjore të Policisë së Shtetit.

2. Policia e Shtetit zbaton kriterë të drejta dhe të besueshme të vlerësimit të performancës për të gjithë organizatën, strukturat dhe personelin e saj.

3. Me anë të vlerësimit të performancës synohet:

a) të vlerësohet nëse puna po kryhet brenda politikave dhe procedurave të vendosura;

b) të matet arritja e qëllimeve afatshkurtra dhe afatgjata;

c) të vlerësohet përdorimi i pajisjeve, armëve dhe burimeve të tjera dhe mjeteve teknike të Policisë së Shtetit;

ç) të rekomandohen mënyrat, rrugët dhe burimet për përmirësimin e performancës së strukturës që inspektohet.

4. Vlerësimi i performancës së strukturave të Policisë së Shtetit realizohet nga:

- a) titullarët e strukturave të Policisë së Shtetit në të gjitha nivelet strukturore;
- b) struktura përgjegjëse për vlerësimin e standardeve profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

5. Në vlerësimin e performancës përfshihen edhe konkluzionet, vlerësimet apo rekomandimet nga strukturat e specializuara në ministrinë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, institucionet e pavarura shtetërore, si edhe organizata partnere, kombëtare apo ndërkombëtare, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e rendit dhe sigurisë publike.

6. Nëse treguesit e performancës së strukturës policore, të vlerësuar përmes procesit të monitorimit të brendshëm dhe/ose të jashtëm, nuk janë realizuar brenda një periudhe 1-vjeçare dhe kur nga organet audituese/inspektuese rekomandohet të ndërmerren masa disiplinore apo administrative, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit urdhëron fillimin e procedimit disiplinor. Kur nga procedimi disiplinor konstatohet mosrealizimi i treguesve të performancës së strukturës së vlerësuar, drejtuesi i kësaj strukture lirohet nga detyra dhe ulet me një gradë.

Neni 133

Llojet e vlerësimeve

1. Vlerësimi i performancës së strukturave të policisë bëhet në mënyrë periodike sipas planifikimit vjetor, miratuar nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe realizohet nëpërmjet:

- a) vlerësimit në vend;
- b) analizimit të raporteve të punës, analizave, informacioneve dhe të dhënave të tjera.

2. Për vlerësimin e performancës së strukturave të Policisë së Shtetit, struktura përgjegjëse për vlerësimin e standardeve profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit apo titullarët e strukturave të Policisë së Shtetit, në të gjitha nivelet strukturore, kryejnë:

- a) vlerësime të zakonshme;
- b) vlerësime të veçanta.

3. Procedurat, mënyrat dhe protokollet e vlerësimit të performancës, përgatitja e raportit të vlerësimit, kushtet për vlerësimet e zakonshme dhe të veçanta të performancës, verifikimi i zbatimit të rekomandimeve dhe aktet që hartohen gjatë vlerësimit të performancës, përcaktohen në rregulloren e Policisë.

Neni 134

Monitorimi i jashtëm i veprimtarisë së policisë

1. Monitorimi i jashtëm kryhet nga autoritete dhe institucione përgjegjëse për vlerësimin e performancës dhe përmbushjes së objektivave institucionale të Policisë së Shtetit për garantimin e rendit dhe sigurisë publike, aspektet e ligjshmërisë në veprimtarinë e saj dhe integritetit, menaxhimit të buxhetit, burimeve njerëzore dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

2. Drejtuesit e Policisë së Shtetit raportojnë drejtpërdrejt për veprimtarinë e strukturave policore, përmbushjen e objektivave të Policisë së Shtetit në lidhje me rendin dhe sigurinë publike dhe situatën e kriminalitetit në vend në ato komisione apo forume të sigurisë, ku Policia e Shtetit është anëtare.

3. Drejtuesit e Policisë së Shtetit raportojnë dhe informojnë ministrin, në kuadër të raportimeve të tij, në komisione të ndryshme për rendin dhe sigurinë publike të organeve apo institucioneve kushtetuese, si: Kuvendi, Presidenti, institucionet e pavarura, në Këshillin e Ministrave dhe në institucione apo forume, organizma të tjera, brenda dhe jashtë vendit.

4. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit i raporton ministrit aktivitetin vjetor të Policisë së Shtetit dhe realizimin e objektivave.

5. Drejtori i përgjithshëm i Policisë i raporton ministrit dhe paraqet raporte, informacione dhe dokumente të tjera për çështje të përgjithshme ose të veçanta, që lidhen me veprimtarinë e Policisë së Shtetit, sa herë që i kërkohet.

6. Drejtori i përgjithshëm i Policisë i paraqet Komisionit për Sigurinë Kombëtare raportin vjetor të veprimtarisë.

7. Drejtori i përgjithshëm i Policisë jep shpjegime dhe informon për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tij sa herë që i kërkohet nga Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

KREU XVII MBËSHTETJA E POLICISË

Neni 135

Simbolet, armët, mjetet, pajisjet, uniforma dhe shenjat e Policisë së Shtetit

1. Policia e Shtetit ka flamurin dhe stemën e saj.
2. Uniforma dhe shenjat dalluese të Policisë përdoren vetëm gjatë shërbimit ose për shkak të tij. Paraqitja, forma dhe elementet përbërëse të gradave, sipas këtij ligji, janë pjesë përbërëse e uniformës së Policisë dhe mbahen vetëm nga punonjësit e Policisë aktivë gjatë ushtrimit të detyrës dhe ata në pension, në raste festash dhe ceremonish, sipas përcaktimeve në rregulloren e Policisë. Paraqitja e flamurit dhe stemës, paraqitja e jashtme e gradave dhe e uniformës, si dhe e përbërësve të tyre, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Struktura të veçanta të Policisë trajtohen me veshje civile. E drejta e trajtimit me veshje civile, sipas kësaj pike, përfitohet nëpërmjet kompensimit në vlerë monetare, në masën dhe sipas rregullave të përcaktuara me urdhër të ministrit.
4. Punonjësi i policisë pajiset me dokumentin dhe medaljonin zyrtar të identitetit, të cilat i paraqet në çdo rast të kryerjes së detyrës. Forma, përmasat dhe të dhënat, që përmban dokumenti identifikues dhe medaljoni zyrtar i identitetit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Punonjësit e policisë kanë të drejtë të mbajnë armë zjarri dhe armë të tjera. Llojet e armatimit, kimikateve, substancave neuroparalizuese dhe mjeteve të tjera për përdorimin e forcës nga Policia përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Mjetet, telefonat celularë dhe pajisje, të tjera nga ato, të përcaktuara në këtë pikë, i jepen për përdorim Policisë, sipas përcaktimeve në rregulloren e Policisë.

Neni 136

Rregullorja e Policisë së Shtetit

Rregullorja e Policisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 137

Buxheti i Policisë së Shtetit

1. Buxheti i Policisë së Shtetit është program i veçantë brenda buxhetit të ministrisë, të emërtuar “Policia e Shtetit”.
2. Drejtuesi i këtij programi është drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe buxheti i këtij programi miratohet në ligjin vjetor të buxhetit.
3. Përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si drejtues i programit buxhetor, si dhe të drejtuesve të njësive shpenzuese, në përbërje të këtij programi për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, menaxhimin financiar dhe kontrollin, ruajtjen e mbrojtjen e aktivëve në përdorim, ushtrohen sipas legjislacionit financiar në fuqi.

Neni 138

Fondi i veçantë

1. Buxheti i Policisë së Shtetit ka një zë të veçantë, që arrin maksimumi 1% të buxhetit vjetor të Policisë së Shtetit për të shpërblyer personat e punësuar për operacione speciale policore, informatorë dhe për programe për mbrojtjen e dëshmitarëve.

2. Fondi i veçantë administrohet nga drejtuesi i njësisë shpenzuese në bazë të rregullave dhe kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe rregullave të përgjithshme të ekzekutimit të buxhetit.

3. Fondi i veçantë nuk u nënshtrohet rregullave të prokurimit publik.

4. Fondi i veçantë auditohet nga shërbimet e kontrollit të brendshëm financiar të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Neni 139

Donacionet për Policinë e Shtetit

1. Policisë së Shtetit, në cilësinë e personit juridik publik, dhe çdo punonjësi policie, i ndalohej pranimi i donacioneve. Përgjithësisht, Policia e Shtetit pranon donacione vetëm nga organizma, përfaqësues të komunitetit të biznesit. Donacioni mund të pranohet vetëm në rast se, pas shqyrtimit paraprak nga struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, rezulton që nga donacioni nuk ka rreziqe korrupsioni ose konflikti i interesit. Donacioni mund të pranohet vetëm me miratimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe, në çdo rast, përfitimi i donacionit bëhet publik.

2. Policia e Shtetit mund të pranojë donacione nga organizata ndërkombëtare ose shtete të tjera apo përfaqësues të tyre, me miratimin paraprak të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.

3. Rregullat dhe procedurat për pranimin e donacioneve nga Policia e Shtetit përcaktohen në rregulloren e Policisë.

KREU XVIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 140

Dispozita kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, punonjësit e Policisë së Shtetit me gradën “inspektor”, “inspektor i dytë” dhe “inspektor i parë” marrin gradën “inspektor”, sipas këtij ligji.

2. Koha e qëndrimit në gradën “inspektor”, “inspektor i dytë” dhe “inspektor i parë” të punonjësve të Policisë së Shtetit, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, për efekt të ecurisë në gradë, konsiderohet si kohë e qëndrimit në gradën “inspektor”, sipas këtij ligji.

3. Deri në datën 1 janar 2026, punonjësit e Policisë me gradën “inspektor”, “inspektor i dytë” dhe “inspektor i parë” përfitojnë pagën sipas parashikimeve të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, pavarësisht që, për shkak të këtij ligji, marrin gradën “inspektor”.

4. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 141

Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 53, pika 2; 66, pika 2; 67; 81, pika 5; 100, pika 7; 101, pika 5; 102, pika 4; 104, pika 4; 105, pika 3; 107, pika 2; 108, pika 2; 109, pika 2; 111, pika 1, shkronja “ç” dhe pika 2; 127, pika 6; 128, pika 7; 130, pikat 8 dhe 9; 135, pikat 2, 4 dhe 5; 136; 138, pika 2.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike të nxjerrë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 40, pika 4; 41, pika 4; 46, pika 6; 56, pika 2; 69, pika 2; 71, pika 3; 72, pika 5; 74, pika 4; 76, pika 4; 77, pika 2; 125, pika 3; 130, pika 10; 135, pika 3.

3. Ngarkohen ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të nxjerrin udhëzimin e përbashkët, në zbatim të neneve 36, pika 3, dhe 38, pika 2.

4. Ngarkohen ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, prokurori i përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të pikës 5 të nenit 40.

5. Ngarkohen ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, prokurori i përgjithshëm dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të pikës 3 të nenit 112.

6. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 27, pika 3; 34, pika 3; 39, pika 4; 41, pika 3; 46, pika 7; 57, pika 5; 80, pika 4; 91, pika 1, shkronja “ç”.

7. Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 142

Shfuqizimi i akteve

Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, dhe çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 143

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare shtesë nga data 1 janar 2026.

Miratuar në datën 26.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 286, datë 5.8.2024, të presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.